



**"A KA NJERI, TA TAKOJMË  
E TË FLASIM ME TË?"...**



**HOBISTAT E SHKATËRRIMIT  
TË FAMILJEVE!**



**TRASHËGIMIA E FEMRËS  
DHE ÇËSHTJA E BARAZISË**

Viti XV - Nr. 10 (176),  
Tetor, 2017

Botim i Myftinisë Shkodër

# UDHA ISLAME

*E përmuajshme  
Informative - Fetare  
Kulturore - Edukative*



## **"O NJERËZIT E ZOTIT..!"**, *Thirrja e urtë* **E HAFIZ SHEUQET BORIÇIT..**

"Ai njeri qi përpiqet për me fituë ushqimin e vetvetes si edhe atë të familjes së tij, do të ketë shpërblimin e një adhuruesi ascetik.

Feja e jonë kërkon punë prej nesh, kërkon që muslimani të jetë i shtrënjtë dhe hije-rëndë dhe jo parazit mbi të tjetët, i poshtër dhe i ofenduëm. Kushdo qi e len punën dhe mërzitet për me punuë dhe me fituë shùjtën e tij, ai e ka humbë shpresën, kështu qi gjendja dhe fundi i tij âsht rrënim humbje e zhdukje!"

**15** vjet  
Tetor 2002 - 2017

**Respekt dhe mirënjohje për kontribuuesit, lexuesit,  
pasuesit e mesazheve që rrezaton numër pas numri!**

*"Udha Islame"*



**Imam Muhamed Sytari**  
Myfti i Zonës Shkodër

## “A KA NJERI, TA TAKOJMË E TË FLASIM ME TË?” ...

*“Kam frikë, mos më pyet All-llahu në ditën e llogarisë,  
për dikë që mund ta kisha takuar për ta ftuar në Islam..., se përse s’e bëra!”*

Duke buzëqeshur, Hoxha i kishte thënë: “Kam frikë, mos më pyet All-llahu në ditën e llogarisë, për dikë që mund ta kisha takuar për ta ftuar në Islam..., se përse s’e bëra!”

Përherë e më shumë më mundon gjuha e ashpër e përballjeve me realitetet islamofobe, partizanët e saj dhe shoqërinë tonë që rrëshqet si pa u ndjerë drejt afetarizmit dhe shturrjes materiale.

Ne jemi thirrës islamë, kemi detyrime pa fund ndaj shoqërisë sonë shqiptare, që e jeton Islamën prej shekujsh, në harmoni me shpirtin dhe kulturën që rrezatojnë ajetet dhe trashëgimia e të dërguarit të Zotit!

Sot, pas dekadave të lodhshme të mbushura me pezëm e gërryerje shumëllojshme në trupin e vetëdijes islame kombëtare, jemi këtu, jemi këta!

Ne jemi thirrës islamë dhe detyra e jonë është të thërrasim popullin tonë në Islam; në fenë e baballarëve të largët dhe atyre të afërt! T’i themi kujtdo që punon pa ndërprerje kundër

kësaj Thirrjeje të shenjtë, se Islami është ajka e shpalljeve hyjnore, bashkimi i Ma të Mirëve nga shekujt e shkuar, garanci për të prodhuar modele garante që i sigurojnë të sotmes dhe të ardhmes besimin me dije, moralin me ndershmëri, civilizimin me drejtësi, frikën e Zotit me dashuri, respektimin e shenjtërive me tolerancë, edukimin me logjikë, ruajtjen e paqes me pastërti, distancimin nga dhuna me dinjitet, humanizmin me respekt të origjinës njerëzore, mbrojtjen e të dobët me krenari, ndërtimin e urave të komunikimit me dialog etj.

“Kam frikë, mos më pyet All-llahu në ditën e llogarisë, për dikë që mund ta kisha takuar për ta ftuar në Islam..., se përse s’e bëra!”

Është e madhe kjo fjali..., më e madhe se krejt zhurmat që shkaktojnë përplasjet e pakuptimta që dikush i orkestron pas kuintave dhe në kurriz të së sotmes dhe të ardhmes së shoqërisë sonë dhe të mbarë njerëzimit...!

*Shkodër, 27 shtator 2017*



## “HAXHI..!”

**S**a bukur, kur e thërrasim dikë: “Haxhi..!”! Dashje pa dashje, na përfshin në botën e bardhë të besimit, paqes e dorëzimit tonë para duarve të Krijuesit Mëshirëplotë, që edhe Haxhin e bëri një stacion të rëndësishëm që përketen më së miri Dashninë e Tij për ne!

Ditë pas dite, teksa afrohem me momentin e madh të kalimit drejt së përtejmes, impulset e shumta që na kujtojnë se kush jemi dhe çfarë misioni kemi në jetë, na forcojnë edhe më shumë në rrugëtimin tonë drejt përhapjes së Mëshirës, me dinjitet e krenari!

Asgjë dhe askush s’e frenon dot përhapjen e paqës të vlerave dhe të vërtetave të Islamit, që me bardhësinë e tij, mbulon përherë e më shumë botën tonë me balsamin shëruës të lëngatave... Është alternativë garante, për të cilën është betuar Vetë Zoti në Librin e Tij: “Thuaj: Erdhi e vërteta..!”

**Imam Muhamed B. Sytari**  
*Shkodër, më 24 shtator 2017*

## MESAZH URIMI ME RASTIN E FILLIMIT TË VITIT TË RI SHKOLLOR 2017-2018

**T**Ë dashur bij e bija,  
NXËNËS DHE KËRKUES  
TË DIJES, TË NDERUAR  
MËSUES EDUKATORË,

**DITA E HËNË, MË 11 SHTATOR  
2017, SHËNON PËR JU FILLIMIN E  
NJË VITI TË RI SHKOLLOR, NDREYSH  
THËNË, MUNDËSINË E RRIJES NË DIJE  
TË DOBISHME, EDUKIM, KULTURË E  
EKSPERIENCA TË REJA TË VYERA PËR  
JETËN.**

**NGA MEDINEJA E NDRIÇUAR E  
RESULULL-LAHUT (A.S), JU UROJ  
ME ZEMËR DHE LUTEM QË TË KENI  
SUKSESE NË KËTË RRUQËTIM TË RI!**

**JU FTOJ, QË PËRPPJEKJEN DHE  
SAKRIFICËN TUAJ, QË NIS QË NË ORËT  
E PARA TË KËSAJ DITE PËR JU, T’IA  
KUSHTONI ALL-LLAHUT, ZOTIT TUAJ.  
D.M.TH, ME HEDHJEN E HAPAVE TË  
PARË TEKSA DILNI NGA SHTËPIA, TË  
THONI ME ZEMËR: “ZOTI IM, MA  
LEHTËSO KËTË RRUQËTIM NË KËRKIM  
TË DIJES!”.**

**PËR KËTË, ZOTËRIA I BIJVE  
TË ADEMIT, HZ. MUHAMMEDI  
(A.S), QË U DËRQUA ME THIRRJEN:  
“LEXO ME EMRIN E ZOTIT TËND QË  
KRIJOI...”, THOSHTË: “AI QË NDJEK  
NJË RRUQË NË KËRKIM TË DIJES, DO  
IA LEHTËSOJË ALL-LLAHU NJË RRUQË  
PËR NË XHENNET!”**

**TË DASHURIT E MI,  
SHOQËRIA DHE VENDI YNË**

**KANË NEVOJË PËR DIJE ME MORAL,  
QË NDËRTON TË SOTMEN DHE JEP  
ÇARANCI PËR TË ARDHMEN!**

**KA NEVOJË PËR MËSUES  
EDUKATORË, QË KUPTOJNË DREJTË  
SE FËMIJËT PARA DUARVE TË TYRE  
JANË NJË AMANET I SHUMËFISHTË, QË  
I ËSHTË BESUAR NGA ZOTI, FAMILJA,  
SHOQËRIA!**

**KA NEVOJË QË SHKOLLA TË  
MOS E HUMBË MISIONIN E SAJ;  
PËRKUNDRAZI, TË VAZHDOJË TË  
JETË DHE TË MBETET BURIM I  
PASHTERSHËM EDUKIMI, BESIMI,  
SIGURIE, ÇARANCIE PËR RUAJTJEN  
E EDUKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË  
KAPACITETEVE INTELEKTUALE DHE  
DHUNTIVE TË FËMIJËVE TANË!**

**JU UROJ ME ZEMËR NJË VIT TË  
MBARË, PLOT PËRPPJEKJE DHE  
ARRITJE, REZULTATE DHE SIHARIOË,  
QË JETËS I JAPIN KUPTIM, TË SOTMEN  
ZBUKUROJNË ME SHKËLQIMIN E  
DITURISË DHE URTISË, TË ARDHMEN  
E BËJNË MË OPTIMISTE PËR TË MIRËN  
E INDIVIDIT SHOQIPTAR, SHOQËRISË,  
KOMBIT E MBARË NJERËZIMIT!**

**ALL-LLAHU JU DASHTË, JU  
BEGATOFTË DHE JU DHASHTË  
SUKSESE!**

**IMAM MUHAMED B. SYTARI  
Medineja e Ndriçuar,  
10 SHTATOR 2017**



## DUHET MEDOEMOS TË KETË NJË RIZGJIM...

“Sa shumë kemi nevojë ne muslimanët të kuptojmë si duhet fenë tonë, pas asaj që dëshmuam, prej akuzave devijuese ndaj nesh me ekstremizëm dhe terrorizëm, si rezultat i kompleteve të armiqve të ymmit, keqkuptimit tonë të vlerave tona dhe moslartësimit të udhëheqësve dhe dijetarëve tanë në gradën e bartjes së amanetit!

Arabët dhe muslimanët mbetën pas popujve të tjerë, prandaj duhet medoemos të ketë një rizgjim intelektual, rilindje ekonomike dhe mbrojtje të fisnikërisë njerëzore të popujve mbarë, për të qenë të gjithë, dorë për dorë drejt një të ardhmeje premtuese më të mirë!”

**Dr. Salahudin Ahmed Keftaro**  
*Damask, 19 shtator 2017*



Sheikh Muhamed El-Gazali

## HOBISTAT E SHKATËRRIMIT TË FAMILJEVE!

*"O ti i Dërguar, përse po bën haram atë që ta ka lejuar Allahu, duke kërkuar razinë e bashkëshorteve tuaja. Allahu është Falës, Mëshirues. Allahu jua ka bërë obligim legjitimitetin e betimeve tuaja". - (Kur'an, Et-Tahrim: 1)*

lidhjet e fëmijëve me xhaminë, derisa të siguroheni se ata i kryejnë rregullisht pesë kohët farz (obligim) të namazit. Ndërsa ti, duhet të kryesh edhe kefaretin (shlyerjen) e betimit; të ushqesh dhjetë të varfër, nëse je i pasur, ose të agjërosh tre ditë, nëse je i varfër..., dhe, mbaje gruan në shtëpi!

Iku burri dhe pas disa ditësh më erdhën hoxhallarët, të cilët i kishin dhënë fetva se, gruaja e tij konsiderohej e ndarë, me divorc të përhershëm. Më pyeten: Si i ke dhënë fetva për lejimin e gruas së tij? Ne këtu jemi pasues të medhhebit mailiki në medhheb dhe këtë që ka bërë e konsiderojmë divorc të madh.

U thashë: Medhhebi im është tjetër dhe ne shikojmë se, ndalimi i hallallit është betim, e shlyerja e tij është shlyerje betimi. Në librin e saktë të Muslimit, transmetohet se Ibn Abasi ka thënë: "Nëse burri e bën haram gruan e tij, ky është betim dhe për të bën shlyerje betimi". Në një transmetim tjetër: Një njeri shkoi te ai dhe i tha: Unë e kam bërë haram gruan time. Ibn Abasi i tha: "Gënjen, ajo nuk është haram për ty! Pastaj i lexoi ajetin: "O ti i Dërguar, përse po bën haram, atë që ta ka lejuar Allahu, duke kërkuar razinë e bashkëshorteve tuaja. Allahu është Falës, Mëshirues. Allahu jua ka bërë obligim legjitimitetin e betimeve tuaja". Ti ke për detyrë të bësh shlyerje

betimin tënd!!

Për derisa ekziston një mendim i respektuar islam, atëherë përse të fanatizohemi ndaj asaj që jemi mësuar! Nëse ajo që nuk e njohim, është më e mirë dhe më e përshtatshme për njerëzit?

Njëri prej tyre, dyshues, më thotë: Siç duket, ti nuk e do Malikun dhe medhhebin e tij!

I thashë: Eudhubil'lah (i kërkoj mbrojtje Allahut) prej urrejtjes së njerëzve të mirë. Unë në namaz, pasoj Malikun, ku nuk e këndoju Fatihanë, kur imami falet me zë dhe e këndoju atë kur imami falet pa zë, duke ditur se, Ebu Hanife, medhhebin e të cilit e kam mësuar, e ndalon leximin e Fatihasë, pa marrë parasysh se, imami e lexon me zë, apo pa zë! E kam parë më të arsyeshme këtu, ta pasoj Malikun!

Unë e urrej fanatizmin e verbër dhe për sa i përket çështjeve të familjes dhe marrëdhënieve shoqërore, parapëlqej çdo mendim që siguron interesin dhe dobinë publike e private dhe miratoj atë çfarë njerëzimi bashkëkohor hedh në të prej respektit të të natyrshmes dhe të drejtave të njeriut! Unë nuk jam mendjelehtë, që të tërheq dyshimet e të prish imazhin e Islamit.

*Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:*

**Lavdrim Hamja**



Xhahid Bushati, shkrimtar

## BOTA DHE RREZATIMI DITUROR I HAFIZ SHEUQET BORIÇIT

të mrekullueshëm dhe përkujdesje të përkorë. Me këtë "gjuhë" flet Myftinia ndaj vlerave të botës myslimane e shkodrane, ndaj vlerave të qytetit tonë, Shkodrës. Kjo është arsyeja që broshura mbyllet me një kurorë të artë fraze dhe urimi rrëzëllitës, i cili është: "All-llahumme pranoje këtë këshillë të urtë dhe këtë hytbe plot udhëzim e mirësi nga Hafiz Sheuqet Boriçi dhe, lartësoje mekamin e tij në ditën e gjykimit, ja Allah! Amin!"

E shfletoj kujdesshëm... Është një hytbe e ligjruar nga Hafizi, dhe e botuar në revistën "Kultura Islame", viti 1, fruermars, 1940 – XVIII, (Muh. –Safer, 1358), nr. 6-7, f. 266-267 e në vijim). Rrëfimi ka ndodhur 77 vjet më parë (ndoshta edhe më herët...). Mendojmë që Hafizi duhet të ketë qenë afro 56 vjeç.

Në fakt, ajo ligjëratë dhe komunikim nuk është thjeshtë një hytbe. Në thelb është Urti. Në thelb është Kulturë. Në thelb është realiteti i ditës dhe realiteti i së nesërme. Në thelb është Rrezatim, - pjesë e botës së Hafizit. Thirrje që udhëton e vazhdon rrugëtimin fisnik. Përrjetësisht, - ky rrugëtim!..

Hytbeja-urti është pjesë, - siç e thashë më lart, - e botës së Hafizit. Dituria e tij nuk mbeti vetëm në kohën që jetoj. Mesazhet e asaj diturie kapërcyen dhe vazhdojnë të kapërcejnë kohërat. Janë sot më shumë se kurrë aktuale. Kjo urti dhe të tjerat që la pas, ridimensionojnë figurën e Sheuqet Boriçit. Kjo nuk është pak. Secili nga ne e ka të domosdoshme të njoh dritën e kësaj Diturie.

Kam pasur rastin ta njoh. E njohu fëmijëria ime disa herë. Arsyeja e parë, se edhe unë kam lindur në lagjen e dritshme "Perash". Arsyeja e dytë, se edhe gjyshja ime (nga baba) (për këtë jam fatlum) ishte nga dera e e respektueshme e plot dinjitet e atdhetarizëm e fisit të Boriçëve.

Hafizi me urtinë e tij ishte pjesë e qytetërimit shkodran. Nuk e di sa u kuptua apo nuk u kuptua sa duhet në atë kohën e jetës së tij. Por ama di që Dija e tij e atëhershme nuk e ka prerë udhëtimin për asnjë çast. Ajo, sot, na flet me gjuhë e vlerave dhe të Modernitetit. Jo kurdoherë e gjejmë një të tillë pasuri. Kjo pasuri për gjeneratat e ardhshme është një dhunti fatlume dhe e pazakontë. Duhet shfletuar...

Rruga e Hafizit që e dritëshme. Dritësoi më fuqishëm viteve që do të

vinin... Çka do të thotë se vetë jeta e Hafizit ishte amanet. Hafizi i nderuar ndërroi jetë në vitin 1965. Është viti, kur në qiellin edhe të Shkodrës sime sapo kishin nisur shtegtimin retë e zeza e të pabesta laike 'pa din e pa iman'. Mbi institucionet fetare dhe në jetët e personaliteteve fetare po binin një nga një rrufetë e egra të shkatërrimit të fesë myslimane. Egërsia komuniste, me këtë veprim, krijoi një nga tragjeditë më të mëdha të historisë ndaj popullit të vet: Humbjen e besimit në fe. E thënë ndryshe: të shkatërrohesh. E thënë ndryshe: një popull të mbetet në mjerim të plotë dhe i paorientuar.

- "O njerëzit e Zotit!.." – është thirrja e urtë e Hafiz Sheuqet Boriçit, thirrje që i ngjan rrezes së dritës.

Mbase është e nevojshme një interpretim i kësaj sintagme të mrekullueshme: "O njerëzit e Zotit!.." E para, elementi thirrës ka karakter përgjithësues. Fushëpamja është gjithëpërfshirëse. E dyta, në aspektin komunikativ kemi një tërheqje të vëmendjes. E treta, protagonizmi, pra në qendër janë njerëzit, ata që mbartin mbi shpatullat e tyre ndërtimin e familjes. E katërta, elementi i të drejtuarit janë njerëzit e jetueshëm, që i japin jetë jetës. E pesta, akti i besimit në Zot dhe pranimi i këshillave dhe porosive të tij, përsëri nga fushëpamja është gjithëpërfshirëse. E gjashta, virtyti është themeli i shpirtit të myslimanit. Në të gjitha këto alternative që përmenda, zë fill, lulëzon dhe shndrit diapazoni i gjerë dituror i Hafizit.

Ja, pse amaneti i Hafizit të nderuar, edhe pse kishte ndërruar jetë (Qoftë i Xhenetit!) ishte dhe vazhdon të jetë: "O njerëzit e Zotit!.." Kjo sintagmë, sigurisht, ka dalë nga shpirti i ditur i Hafizit. Përveç atyre që përmenda më lart, e ka edhe një tjetër domethënie, e cila është: Nuk ka robëri që ia mbyll derën Hafizit të nderuar, sepse Mendjendrituri Hafiz Sheuqet Boriçi, jo vetëm këtë sintagmë që ka funksionin e titullit dhe lejtmotivin e shkrimit, por çdo fjalë të Hytbes (-ve) u ka frymën e tij. Fryma është dimension i figurës së tij.

Hafizi me diturinë e tij na flet gjithnjë e gjithnjë... Po e përsëris: amanetin e tij Hafizi e la përmes Hytbes. Çdo germë e saj është amanet. Nderim Hafiz Sheuqet Boriçi!

*Shkodër, 06.10.2017*

**N**jë burrë i lodhur më trokiti në derë dhe po fliste me fjalë të tronditura për familjen dhe pasurinë e tij. Ndjeva se po më kërkonte ndihmë!

I thashë me qetësi: Çfarë ke?

Më tha: Në një moment zemërimi, humba durimin dhe i thashë gruas time: "Ti je haram për mua!" Hoxhallarët më kanë dhënë fetva se, unë e kam humbur gruan time dhe nuk më lejohet më kurrë.

I thashë burrit: A i falë pesë kohët e namazit?

Tha: Po.

I thashë: Po gruaja jote?

Hezitoi pak, pastaj tha: Falet nganjëherë.

I thashë: Po fëmijët tuaj?

Tha: Disa prej tyre falen, ndërsa disa të tjerë nuk i kushtojnë rëndësi namazit!

Heshta gjatë, sikur po kërkoja ndonjë zgjidhje për të, pastaj i thashë: Ta kthejmë gruan tënde me një kusht!

Tha: Çfarë kushti?

I thashë: Të kujdeseni për namazin, ti dhe gruaja jote, e të mbikëqyrni

**PËR DERISA EKZISTON NJË MENDIM I RESPEKTUAR ISLAM, ATËHERË PËRSE TË FANATIZOHEMI NDAJ ASAJ OË JEMI MËSUAR! NËSE AJO OË NUK E NJOHIM, ËSHTË MË E MIRË DHE MË E PËRSHTATSHME PËR NJERËZIT?**





Arben Halluni, teolog

## YMETI ISLAM, YMET I HARMONISË

fenë islame) Ne u bëmë juve një popull të drejtë (një mes të zgjedhur)", - (El-Bekare: 143)

Një nga specifikat e këtij ymeti është edhe "mesatarja", çka do të thotë se ymeti është i mesëm në çdo gjë: në mendim, në besim, në adhurim dhe kryerjen e riteve, në vlera morale dhe edukatë, në punë e sjellje, në lidhje dhe organizime, në politikë dhe ekonomi dhe në të gjitha marrëdhëniet ndërnjerëzore. Dhe pikërisht ky është kuptimi i ajetit të lartpërmendur: "Dhe ashtu (sikur ju udhëzuam në fenë islame) Ne u bëmë juve një popull të drejtë (një mes të zgjedhur) për të qenë ju dëshmitarë (në ditën e gjykimit) ndaj njerëzve", - (El-Bekare: 143) Ndërsa një ajat tjetër kur'anor po në lidhje me këtë kontekst thotë: "Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, urdhëroni për mirë, ndaloni nga veprat e këqija dhe besoni Allahun" - (Ali Imran: 110)

Jo vetëm kaq, por ky ymet me veçorinë e të mesmit, bën të mundur përhapjen e Islamit në të gjitha anët e botës në mënyrën më paqësore, me bindje dhe jo me dhunë, ngase Libri hyjnor, Kur'ani Famëlartë, ka zbritur për të gjithë njerëzimin dhe Pejgamberi i këtij ymeti është dërguar mëshirë dhe paqësor për të gjithë botën.

Duke u mbështetur në këtë të fundit, themi se ymeti islam ka për detyrë misionin e mëshirës dhe atë të lehtësimit, jo atë të ashpërsimit dhe ekstremizmit. Në lidhje me këtë, Pejgamberi (a.s) i është drejtuar ymetit islam me këto fjalë: "Ju jeni sjellë në këtë jetë që të jeni lehtësues (tolerantë) dhe nuk jeni sjellë që të jeni të ashpër (intolerantë)". - (Transmetuar nga Buhariu dhe Ahmedi në Musnedin e tij).

"Shembulli i besimtarëve në miqësinë, solidaritetin, dashurinë dhe mëshirën mes tyre, është si shembulli i trupit, një gjymtyrë po të lëndojë, i gjithë trupi vuan nga pagjumësia dhe ethet". - (Transmetuar nga Muslimi)

"Edhe ata që erdhën pas tyre, thonë: "O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve!" - (Kur'an, El-Hashr: 10)

Meqë Zoti ka deklaruar që besimtarët

*"Dhe ashtu  
Ne u bëmë juve një  
popull të drejtë  
për të qenë  
ju dëshmitarë  
ndaj njerëzve"*

janë vëllezër, le të vazhdojmë sot dhe përgjithmonë të deklarojmë edhe ne këtë vëllazëri me njëri-tjetrin, pa marrë parasysh, racën, prejardhjen apo gjuhën. Le t'i deklarojmë njëri-tjetrit se duhemi dhe të japim prova për këtë. Le t'i pastrojmë zemrat tona nga urrejtja, xhelozia dhe keqësia.

Një ditë, Profeti (a.s) u thotë të pranishmëve: "Tani do të vijë një burrë që është nga banorët e xhennetit."

Kur erdhi personi në fjalë, shokët e Profetit (a.s) panë që ishte një njeri i thjeshtë dhe më se normal. Abdullah ibnu Omer shkoi dhe qëndroi në shtëpinë e tij tre net rresht, me qëllim që të zbulojë ndonjë vepër të veçantë, e cila i kishte dhënë një gradë kaq të lartë. Ai as nuk falej më shumë se të tjerët, as nuk agjëronte dhe as nuk kishte ndonjë gjë tjetër të veçantë. Në fund, Abdullah ibn Omeri i tha: "Më trego se çfarë ke bërë që Profeti (a.s) të ka përmendur nga banorët e xhennetit!"

Burri iu përgjigj: "Kur bie të fle, e pastroj zemrën duke mos i mbajtur mëri dhe urrejtje asnjë besimtar.".

Pra, nëse je në konflikt me dikë dhe ka kohë që i mbani kokën mënjanë njëri-tjetrit, fale në këtë moment dhe shko, foli. Në çastin që Zoti i sheh zemrat tona të dëlira dhe të pastra, na fal, na mëshiron dhe na ndihmon.

Ebu Hurejra (r.a) rrëfen se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Nuk do të hyni në xhennet derisa të besoni dhe nuk do të besoni përderisa ta doni njëri-tjetrin. A t'ju udhëzoj për një gjë? Shpërndajeni selamin mes jush! Pra, nëse e bëni këtë, do të duheni mes veti".

Ebu Hurejra (r.a) rrëfen se Pejgamberi

Ervil Kuçi,  
imam - xhamia Dërgut

Kur flasim për Hixhretin, menjëherë na vjen në mend ajo që kemi mësuar në historinë tonë islame, pra shpërngulja që bëri pejgamberi jonë (a.s) nga Meka në Medinën e Ndriçuar. Duke u bazuar në këtë ndodhi dhe fakt historik njëkohësisht, është krijuar dhe kalendari jonë islam, fillimi i të cilit bazohet mbi vitin e hixhretit të Pejgamberit (a.s).

Kjo ndodhi është një mësim i mirë për rininë tonë besimtare. Prej saj mësojmë se hixhreti i Pejgamberit (a.s) nuk ishte thjesht një udhëtim nga një qytet në tjetrin, apo një shpërngulje për interesa personale, ashtu sikurse nuk ishte thjesht një ndodhi për t'u treguar.

Hixhreti i Pejgamberit (a.s) ishte një urtësi hyjnore dhe pjesë e planit të të Dijsmit, e cila shërbeu më tepër në suksesin e thirrjes në islam, dhe besoj që ky hixhret duhet të analizohet me kujdes në të gjitha detajet, në mënyrë që të konceptojmë si duhet urtësinë e tij.

Para se të marrim ta analizojmë konceptin e hixhretit, le ta shpjegojmë më qartë përkufizimin e tij.

Fjala Hixhret, e përkthyer në gjuhën shqipe do të thotë: Emigrim, shpërngulje

(a.s) ka thënë: "Largojuni dyshimeve, pasi ato janë forma më e rreme e të folurit! Mos u bëni kureshtarë në lidhje me punët (intime) të njëri-tjetrit! Mos jepni urdhra për ta lartësuar vetveten! Mos u bëni ziliqarë ndaj njëri-tjetrit! Mos e urreni njëri-tjetrin! Mos flisni keq për njëri-tjetrin, por bëhuni robër të denjë të Allahut, e vëllazërohuni sa më shumë!" - (Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

Duke marrë shkas nga të gjitha këto

## MBI HIXHRETIN NË JETËN E BESIMTARIT

dhe kjo fjalë tek arabët ka dy kuptime:

Hixhret: Nënkupton emigrim ose shpërngulje nga një vend drejt një vendi, që ofron kushte ose të ardhme më të favorshme.

Hixhret: Nënkupton braktisjen e diçkaje që i përket të kaluarës drejt diçkaje të re, më të mirë dhe më me perspektivë.

Në rastin konkret, hixhreti i Pejgamberit (a.s) dhe i shokëve të tij në të vërtetë ishte një shpërngulje nga një vend, si Meka, që ishte vendi më i dashur në botë për Pejgamberin (a.s), ku dominonte idhujtaria dhe arroganca, drejt Medinës së Ndriçuar, me kushte më të favorshme për përhapjen e thirrjes së teuhidit.

Në të vërtetë, Pejgamberi (a.s) dhe shokët e tij nuk po braktisnin Mekën, por arrogancën e banorëve të saj, idhujtarinë e shfrenuar që praktikohesh dita-ditës, veset e injorancës. Ata po bënin hixhret drejt një të ardhmeje më të mirë për thirrjen në Zot, drejt një vendi më të mirë, si Medina e Ndriçuar, ku banorët e saj përfaquan fenë e Allahut me zemër, një vend ku mundësonte praktikimin e ligjeve të Zotit dhe ku idhujtaria, arroganca dhe injoranca nuk kishin hapësirë.

Atëherë hixhreti në botëkuptimin e tij nuk është thjesht një ngjarje historike, por një braktisje zakonesh dhe traditash pagane drejt besimit në Zot, drejt virtyteve dhe parimeve të larta morale! Sepse në fakt, me hixhretin që bëri për hir të Zotit, duke braktisur çdo gjë që ka lidhje me të kaluarën, e cila ishte larg besimit, në realitet është hixhreti i cili është bërë në rrugën e Allahut dhe inshallah ka shpërblimin e

parime që përmenda dua të them se feja islame priret drejt vendosjes së mirëkuptimit të individëve në shoqëri, të harmonisë midis njerëzve me besime të ndryshme fetare, drejt përforcimit të marrëdhënieve të mirëkuptimit dhe të solidaritetit shoqëror midis grupimeve të ndryshme sociale.

Jo vetëm kaq, por marrëdhëniet dhe harmonia ndërfaqetare sjellin pa dyshim një klimë të ngrohtë vëllazërie, si dhe është çelësi për një botë të paqte, e

tij, në këtë botë dhe në tjetrën.

Për këtë, Pejgamberi (a.s) thotë në hadithin, e transmetuar nga Omeri (r.a): "Kush shpërngulet (bën hixhret) për hir të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, atëherë shpërngulja e tij është për hir të Allahut dhe të Dërguarit të Tij". Ai gjithashtu thotë: "Muhaxhir është ai që braktis atë që ka ndaluar Allahut!"

Nga ky hadith i Pejgamberit (a.s) kuptojmë që secili prej nesh nëse përpigjet të braktisë diçka që i përket të kaluarës së tij dhe që është kundrejt rregullave dhe parimeve të Islamit, ky është hixhret, dhe secili prej nesh ka një të kaluar para se të ishte në besim, para se të praktikonte fenë e Zotit, dhe secili prej nesh ka hedhur pas krahëve dhe ka braktisur veset, injorancën, arrogancën dhe rrugën e mosbesimit.

Prandaj përkujtimi i hixhretit të Pejgamberit (a.s) na kujton secilit prej nesh, se duhet të bëjmë hixhret vazhdimisht në jetën tonë të përditshme, hixhret nga veset, nga afetarizmi, nga injoranca dhe nga çdo gjë që bie ndesh me parimet e besimit islam.

Secili prej nesh ka braktisur diçka që i përket të kaluarës, kur ka hyrë në familjen e besimit, secili prej nesh bën hixhretin e tij në jetën e përditshme duke iu bindur Zotit të Gjithësisë.

Hixhreti është mësimi më i mirë për çdo besimtar që e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Hixhreti na mundëson të hedhim pas shpine çdo gjë që është kundrejt parimeve të fesë sonë dhe të përvetësojmë më të mirën prej besimit.

Allahu na e lehtësoftë hixhretin tonë të përditshëm dhe na bashkoftë me Pejgamberin (a.s) në xhennetin Firdeus. Amin!

cila ndikon në zbutjen e raportit dhe mirëkuptimit midis njerëzve. Çdo njeri, i çdo moshe duhet ta pranojë me mirëkuptim tjetrin dhe angazhimi i gjithësecilit është i rëndësishëm në këtë aspekt.

Mendoj se motoja që duhet të jetë në karakterin e gjithësecilit në aspekt të tolerancës dhe harmonisë me njëri-tjetrin është fjala profetike: "Lehtësoni dhe mos vështirësoni, thoni fjalë të mira (të paqta) dhe mos u ngatërroni!"

## “EDUKONI FËMIJËT TUAJ ME DASHURI PËR PROFETIN MUHAMMED (A.S.)” - DR. MUHAMMED A. JEMANI

(LIBËR I PËRKTHYER NGA H. VEHBI S. GAVOÇI - SHKODËR 1996)

### FËMIJËT E PROFETIT (A.S.)

Profeti (a.s) ka pasur dy djem, Kasimin dhe Ibrahimin. Djali i parë i lindi pas katër vajzave, por vdiq i vogël, sapo filloi të mësonte të ecte. I dyti, Ibrahim, i ngjante shumë në pamje Profetit (a.s), prandaj edhe e donte shumë.

Tregojnë se Profeti (a.s) hyri në dhomë, kur i biri po jepte shpirt. E mori nga duart e nënës dhe e vuri në prehër duke e ledhatuar. Mbas pak djali dha shpirt. Nëna me tezen filluan të qajnë me zë, ndërsa Profeti (a.s) i përlotur tha: “O Ibrahim, po të mos ishte vdekja e saktë e se i mbrëmi do të vazhdojë rrugën e të parit, do të isha hidhëruar më tepër.” Mbas pushoi pak shtoi: “Loton syri, hidhërohet zemra, nuk flasim çka nuk i pëlqen Zotit (xh.sh) dhe na, o Ibrahim, jemi të dëshpëruar me ty.”

Kur disa shokë panë dëshpërimin e Muhammedit (a.s) i thanë: “O Profet i Zotit, na ke pasë ndaluar të qajmë të vdekurit!”

Ai Zotëri u përgjigj: “Nuk ju kam ndaluar të jeni të dëshpëruar, por ju kam ndaluar të çoni zërin në vaj dhe të njehni të mirat e të vdekurit, ose të rrahni veten me shputa. Çka shihni tek unë, sot është efekti i zemrës nga dashuria e mëshira që kam. E ai që nuk shfaq mëshirë, nuk gjen mëshirë.”

Rastisi që në ditën që vdiq Ibrahim i zu dielli. Disa sahabë thanë se eklipsi i diellit ngjau si shenjë zie për vdekjen e Ibrahimit. Posa dëgjoi Profeti ato fjalë, tha: “Dielli e hëna janë shenja të Zotit (xh.sh). Nuk zihet për lindjen e kujt apo për vdekjen e tij, nëse shihni atë gjë, faluni e lutuni, deri sa të lirohet.”<sup>1</sup>

Vërtetë Profeti (a.s) i ka dashur fëmijët e vet shumë, por dashuria ndaj fesë që është dërguar të shpallë, ka qenë më e madhe dhe më e lartë.

### CILËSITË KRYESORE TË PROFETIT (A.S.)

Çdo Profet, çdo i dërguar i Zotit ka pasur paraqitje të hijshme dhe zë të bukur, të cilat e plotësojnë hijeshinë e shpirtit, e plotësojnë kthjelltësinë e

1. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslim.

**“Dielli e hëna janë shenja të Zotit (xh.sh). Nuk zihet për lindjen e kujt apo për vdekjen e tij, nëse shihni atë gjë, faluni e lutuni, deri sa të lirohet.”**

mendjes.

Abdullah Siraxhudin, një dijetar i shquar, thotë: “Zoti (xh.sh) e ka krijuar Profetin (a.s) si më të bukurën krijesë njerëzore, më të plotin ndër njerëzit e tjerë.”

Berá, djali i Azizit, thotë: “Profeti ka qenë më i bukur i njerëzve e më i miri në sjellje, nuk ka qenë i gjatë, as i shkurtër.”<sup>2</sup>

Enesi (r.a) vazhdon për Profetin (a.s): “Nuk kam parë njeri më të bukur se Profeti (a.s), të thuash dielli ndriçonte në fytyrën e tij.”

Ndërsa Berai thotë: “Profeti (a.s), ka qenë i bukur si hëna.”

Zonja Aishe, gruaja e Profetit (a.s) e përshkruan në këtë mënyrë: “Ka qenë më i bukur i njerëzve, me lëkurë të ndritshme, kushdo që është munduar të paraqesë pamjen e tij e ka krahasuar me diellin e me hënën, djersa e tij si kokrra e xhevahirit, më e ëmbël e më e këndshme se myshku.”<sup>3</sup>

Ebu Khajthema e përshkruan në këtë mënyrë: “Ka qenë me ballë të lartë, fytyra e tij i dukte si drita e madhe.”

“Nuk kam nuhatë erë më të mirë e më të këndshme, se aroma e atij Zotërie, thotë Enesi, dhe nuk kam prekë me dorë gjë më të butë se duart e Profetit (a.s)”.

Profeti (a.s) ka qenë më i pastërti i njerëzve. I brushonte dhëmbët me

2. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslim.

3. Transmetuar nga Ebu Nuajm.

misvak<sup>4</sup>, porsa zgjohej nga gjumi dhe sa herë merrte abdes, pesë herë në ditë dhe, kur hynte në shtëpi për të pushuar.

Ebu Kirasi dëshmon përmes fjalëve të nënës dhe tezes së vet se, “Nuk kemi parë si këtë burrë, me fytyrë të ndritur, më të pastër në tesha e më të butë në fjalë. Kur fliste, dritë dilte nga goja e tij.”<sup>5</sup>

Të gjitha këshillat e urdhrat e tij për të pastruar rrobat, vendin, ushqimet e pijet, vendin e faljes, faljet, sjelljet, zemrën e tregojnë se sa i pastër ka qenë ai Zotëri.

Po ashtu i nderonte miqtë, gjithnjë i priste me rroba të reja e të përshtatshme. Xhundeli kallëzon: “Kur vijshin miqtë e huej tek ai Zotëri, vishte teshat më të bukura e më të mira e urdhëronte që edhe shokët të vepronin si ai. Kur erdhi delegati i Qabes, ai Zotëri veshi rroba Jemeni, po ashtu edhe Ebu Bekri e Ymeri.”<sup>6</sup>

Një herë erdhi një shok te Profeti (a.s) i veshur me rroba të vjetra e me dhëmbë të zverdhur. Kur doli miku, Profeti u tha shokëve: “Mbldhni diçka ta ndihmojmë këtë nevojtari”. Miku i dëgjoi këto fjalë e u kthye te Profeti (a.s) duke i thënë: “O i dërguari i Zotit (xh.sh) unë nuk jam nevojtari.”

Profeti (a.s) e pyet: “Çfarë pasurie ke?”

- Gjithçka kam, para e mall.

Kur dëgjoi këtë përgjigje Profeti u zemërua e i foli: “Pse nuk vishesh? Zoti (xh.sh) i do ata të cilët e tregojnë nivelin e gjendjen e tyre për të mirat që u ka dhënë Zoti.”

(Shënim: Këtë kaptinë e kam nxjerrë prej një libri që meriton të përkthehet krejt, sepse tregon si ka jetuar ai Zotëri, si ka folur, si ka ndenjur, si ka ngrënë, si ka pirë, si e ka kaluar kohën, çfarë pasurie ka pasur, si e ka ndarë, si ka folur me të tjerët, si është interesuar për shokët e miqtë, si është sjellë me familjen e vet, me fëmijët, me bonjakët. Të gjitha këto çdo mysliman gëzohet, po t'i dijë dhe përfiton kur i zbaton

4. Misvak: kërcelli i së cilës ka fibra të gjata e të forta, që përdoret për të larë dhëmbët, ashtu siç përdoret brusha sot.

5. Transmetuar nga Ebu Nuajm.

6. Transmetuar nga Ebu Nuajm.

të gjitha ato veprime e ato sjellje që lidhen me personin më të madh në botë, të cilin e ka lavdëruar vetë Zoti i Madhërueshëm duke thënë në Kur'anin e bekuar: “Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit.”<sup>7</sup>

Ky libër mban titullin “Zotëria ynë, Profeti Muhammed (a.s)” shkruar nga Hafiz Abdullah Siraxhudin. Zoti e ruajt, pastë shëndet e jetë të lumtur!.

### LINDJA E PROFETIT (A.S) JETIMI I VARFËR

Të gjithë njerëzit e mençur, studiuesit, janë të një mendjeje se jetimi (të mbeturit jetim) ka qenë bekim dhe mëshirë, vobekësia e Profetit Muhammed (a.s) ka qenë mirësi e se edukata e sjellja e mirë ka qenë dhunti e Zotit (xh.sh).

Muhammedi (a.s) lindi nja dy muaj mbas vdekjes së babait të vet. Babai i vdiq në Medine ku kishte vajtur duke u kthyer nga Siria, për të vizituar kushërinjtë e për të marrë disa hurma sipas porosisë së t'et. U sëmur në Medine dhe pas pak kohe, vdiq. U varros në një vend, aty ku sot është xhamia e Profetit (a.s). Më vonë ai vorr u zhduk me rastin e zmadhimit të xhamisë së Profetit, në Medine munevverë.

Kështu pra erdhi Muhammedi (a.s) në këtë jetë, siç thamë, jetim, mirëpo Zoti (xh.sh) me mirësinë e Tij nuk lejoi të jetonte hidhërimet e jetimit, sepse gjyshi i vet, Abdulmutalibi zuri për këtë fëmijë vendin e babait. E mori në shtëpi me të gjithë dashurinë e babës.

I dha tri nëna të dashura, nënën që e kishte lindur, Aminën, nënën që tregoi interes dhe i shërbeu me shpirt, skllaven Bereqet dhe nënën e tij që i dha gjë më se dy vjet dhe u rrit tek ajo, Halime Saedije.

Në vitin e gjashtë të jetës së tij të bekuar, nënë Amineja shkoi për vizitë nga Mekja në Medine. Mori me vete shërbëtores Bereqete dhe djalin e vogël, që të vizitojë varrin e burrit të saj dhe të njihje fëmija kushërinjtë e vet.

Duke u kthyer, sapo arritën në fshatin Ebva, u sëmur nënë Amineja. I erdhën ca dhimbje, pastaj i pushoi trupi dhe u qetësua, derisa dha shpirt ajo grua bujare para syve të djalit e në duart e shërbëtores Bereqete.

Vdiq pra edhe nëna e mbeti kështu ai Zotëri pa nënë e pa baba.

Nuk mund të përshkruhet e as nuk

7. Kur'ani, El-Kalem: 4.

**Të gjithë njerëzit e mençur, studiuesit, janë të një mendjeje se jetimi (të mbeturit jetim) ka qenë bekim dhe mëshirë, vobekësia e Profetit Muhammed (a.s) ka qenë mirësi e se edukata e sjellja e mirë ka qenë dhunti e Zotit (xh.sh).**

mund të dihet se çka ndjeu ai Zotëri në atë moshë fëmijërie, 6 vjeç, se çka do të thotë vdekje. Pau nënën e vet për herë të parë dhe të fundit si pushon e nuk flet, nuk ankon më, nuk i buzëqesh djalit të vet të vetëm, madje as nuk e shikon djalin, as pyet për të. Pau si u ftoh trupi i nënës dhe u bë akull.

Pau edhe si Bereqetja e mbështolli nënën me diçka, i hapi një gropë dhe e vuri nënën e dashur në të vetëm. Më vonë e mbuloi dhe e la nënën nën dhe, në atë vend djerr, pa njerëz e kojsi, në një fshat që quhet Eb-va, pranë një kodre.

Nuk dimë çka i foli ai fëmijë Bereqetes për çfarë bëri ajo me nënën e tij, sa vonoi ajo me lot në fytyrë, me gojë të marrur t'i kallëzonte të voglit çfarë është vdekja, e pse ai që vdes, shtihet në gropë e lihet vetëm. Pastë rahmet!

Para se të vdiste, nënë Amineja tha: “Çdo krijesë do të vdesë, çdo i ri do të vjetërohet dhe çdo gjë do të shkrihet. Unë po vdes, mirëpo kujtimi im do të qëndrojë, se kam lënë një fëmijë të vogël, se kam lënë pastërti.”

Profeti (a.s) vazhdoi rrugën për në Mekë me zemër të vrarë, pa fjalë, pa buzëqeshje. Hynë në shtëpi ku nuk ishte kush, as nëna, as teshat e nënës, nuk dëgjohej fjala e nënës as përkëdhelitet e saj. Nuk kishte veç hidhërim, nuk flisnin, nuk qeshnin, sikur nuk kishin shpirt.

Mbas pak, me rastin e vdekjes së Amineje dhe arritjes së Muhammedit (a.s) erdhi me vrap gjyshi me hidhërim në zemër, e përqafoi të nipin dhe u përpoq me sa mundi t'ia lehtësonte hidhërimin e ta ngushllonte, t'ia kthente dëshirën për jetë duke i shprehur gjithë dashurinë e dhimbjen për të, me qëllim që ai të kuptonte se nuk do të ishte vetëm, mbas sodit do të kishte gjyshin si babë e gjyshen si nënë.

Ibni Is-haku tregon se Abdul Mutalibi ka qenë i pushtetshëm dhe

i përmendur në Mekë, bijtë çdo ditë i shtronin një vend ndeje pranë Qabes, ku priste miqtë në kohë të caktuar.

Gjyshi sa herë shihte se nipi rrinte në vend të tij, e, kur mundohej ndonjë axhë ta largonte, gjyshi u thonte: “Mos e çoni, le të qëndrojë në vend të tij djali” të cilit i bante nderim të veçantë e vinte pranë, e vështronte me përmallim e nderim, se i pëlqente sjellja e tij.

Mbas dy vjetësh, kur Muhammedi (a.s) ishte vetëm 8 vjeç, u sëmur gjyshi, e ditë mbas dite i shtojte sëmundja. Më vonë vdiq, si çdo njeri tjetër, sikur pat thënë nënë Amineja.

Para se të vdiste, gjyshi urdhëroi djalin e vet Ebu-Talibin, të interesohej për nipin e vet e ta konsideronte si fëmijën e tij.

Vdiq gjyshi e u varros nën dhe, si nëna e Muhammedit (a.s)

E mori Ebu-Talibi jetimin me të butë e me fjalë të ëmbla zemre, i tha djalit se që atë ditë do ta kishte atë baba, të shoqen, Fatimen, nënë, e djemtë e tij, vëllezër. Nuk do të mërzhitesh tek ne e nuk do të heqësh keq.

Vërtetë gjeti Muhammedi (a.s) çka kishte nevojë. Ebu-Talibi iu bë si babë, e donte, e preferonte mbi djemtë se ishte i butë. Sa herë gruaja i jepte të hante, sepse fëmijët e saj ia hanin çka kishte përpara.

Më vonë, kur ajo grua vdiq, zonjën Fatime Profeti (a.s) e varrosi në Bekie, u ul në varrin e saj e i ra sipër, para se ta vinin në gropë duke thënë: “Kjo është nëna ime, mbas nënës.” E iu lut Zotit (xh.sh) për të.

Ebu Talibi nuk ishte pasanik, por qenia e Profetit në shtëpi të tij ia shtoi bereqetin që i dha Zoti (xh.sh), ashtu siç kishte vepruar edhe më parë me Halimen, nënën që e rriti.

## “O NJERËZIT E ZOTIT..!”, THIRRJA E URTË E HAFIZ SHEUQET BORIÇIT...

Hafiz Sheuqet Boriçi (1884-1965), konsiderohet si njëri ndër hoxhallarët dhe vaizët elitarë më të shquar të kohës së tij në Shkodër.

Ai është një ndër personalitetet e afirmuara të familjes së nderuar shkoderane, Boriçi, në trungun e së cilës, qëndron plot dinjitet edhe Daut ef. Boriçi (1825-1896), babai i abetareve shqip me alfabet arab, (ku ka krijuar edhe disa shkronja, për të plotësuar boshllëkun e diferencës në mes alfabetëve të dy gjuhëve tona), Kryetari i Komitetit Ndërkrahinor i Lidhjes së Prizrenit dhe Kryetar i Degës së tij për Shkodrën etj.

“Veprimtaria e Hafiz Shefqetit shtrihej në disa fusha. Ai qe një myderriz për përgatitjen e hoxhallarëve të rinj, qe mësues në shkollën pedagogjike, mësues besimi në shkollat fillore shtetërore, qe imam e vaiz në disa lagje të qytetit të Shkodrës” - (F.Luli, I.Dizdari, N.Bushati, “Në kujtim të brezave”, Shkodër, 1997, f. 301).

Në këto shënime studimore, dua të sjell në vëmendjen tuaj disa urti të Hoxhës së shquar shkoderan, H. Sheuqet Boriçi, botuar në revistën “Kultura Islame”, 1940.

Materiali i gjatë, që titullohet: “Përmbi mundimin, përmbi punën”, në fakt, është një hytbe xhumaje e mbajtur nga zotëria e tij në xhaminë e Sulltan Bajazitit (Hynqarit) në Shkodër. (Një nga xhamitë e shumta të Shkodrës, që sot i është uzurpuar trualli, përtej përpjekjeve të shumta për kthimin e tij në identitet, në një vend, ku ligji dhe e drejta legjitime nuk arrihen me njerzillek, mealesef!?)

Hytbeja në fjalë përqendrohet tek puna dhe nxitja që i bën Kur’ani dhe Hz. Muhammedi (a.s) punës, veprimtarisë fizike, angazhimit për të fituar hallall, pushtetit ekonomik, forcës, influencës dhe dinamikës së jetës në Islam.

### “O NJERËZIT E ZOTIT...”

Kështu e nis hytben e tij, i urti H. Sheuqet Boriçi, teksa vazhdon dhe udhëzon, se: “Njeriu në këtë botë nevojitet për ushqimin, veshën dhe banimin e tij. Zoti me Madhnië të Vet, ka depozitue ke ai mendjen, pranë së cilës i ka vuë edhe ngarkesa a detyra, tue e lanë zavendës mbi faqe të dheut dhe tue i bënë të përlëshme dhe të bindëshme për të, të gjitha gjanat qi egzistojnë mbi tokë e mbrendë tokës: shtazë, bimë e minerale.

Prâ, kush nuk punon, nuk ep dobí dhe nuk është i dobishëm, dhe ai i cili nuk është i

dobishëm, është më i ulët se shtaza e egër!

Në qoftë se ka ndonji popull, të cilin e shtyn dhe e mpron Feja e tij mos me qëndruë statik në pikëpamje materjale, ai popull do t’ishin muslimanët, të cilët Feja e tyre i thërrret për me i dhanë randësinë e duhur nevojave materjale, dhe i shtyn për me punuë për botën e tyre, me qëllim të plotësimi t’egzistencës së tyre botnore, tue kërkue me formuë me ‘ta një ideal, një shëmbëll për popujt e tjerë, qi rrojnë mbi faqe të tokës.

Këtë gjâ e vërtetojnë edhe disa prej versetëve të naltë kuranor...” - (Revista “Kultura Islame”, viti 1, fruer-mars, 1940-XVIII, (Muh.-Safer, 1358), nr. 6-7, f. 266-267 e në vijim)

Hytbeja mbi vlerën e punës dhe zhvillimit të dhuntive të Zotit në jetë, mbajtur nga Hafiz Sheuqet Boriçi, këtu e 76 vite më parë, është në të vërtetë një thirrje e lashtë shekullore, që buron nga thellësia e Kur’anit Famëlartë.

### PUNA, SI MJET DREJT JETESËS ME DINJITET E KRENARI

Hytbeja mbi vlerën e punës dhe përfitimit nga “dhuratat e mirësitë e Zotit”, është në thelb të saj thirrje qytetëruese, që nxit muslimanët e çdo kohe për të jetuar me dinjitet e krenari, duke zhvilluar ekonominë dhe duke ndërtuar vizionet e tyre...

Ja sesi kulmon kjo hytbe, ku Hoxha i nderuar, ndër të tjera udhëzon:

[(E din) që të tjerë çajnë e përshkojnë tokën për me kërkue prej dhuratës së Zotit...” - (Kur’ani, El-Muzzemmil: 20)... Zoti qoftë lavduë..., tue urdhënuë edhe të shëtitunit e t’udhëtuëmit mbi tokë për me kërkue të mirën, me këtë mënyrë; Ai urdhënon, qoftë lavduë: “E kur të kryhet namazi, shpërndahuni mbi dheun dhe lypni prej dhuratës së Zotit” - (Kur’ani, El-Xhumua: 10).

Nji kështu Zoti e bënë të ligjëshme për besnikët, me anën e këtyne versetëve, për me u shpërndaë mbi tokë dhe me kërkue prej dhuratës së Tij.

Dhurata e mirësia e Tij nuk shkurohet vetëm tue bënë tregëtië, por përmbledh edhe bujqësinë, industrinë, dituritë, artet dhe çdo gjâ tjetër, qi me të vërtetë mund të numurohet prej dhuratave hyjnore. Dhe këtë mënyrë Zoti, qoftë lavduë, e bënë të lejuëshme për muslimanët me marrë prej popujve të tjerë, në qoftë se nuk i kanë vetë, industrinë, bujqësitë, artet, dituritë etj.

Prâ, o Njerëzit e Zotit! Kushdo qi mvesh petkat e moralevet dhe vetijavat (cilësive -M.S.) Islame, fitoj dhe lumnohet dhe ai që largohet prej Udhës së Islamit, errësohet dhe rrënohet.

Nuk ka morale dhe urtësina më të mira veçse atyne, të cilat na i dha ne Islami, dhe s’ka të mirë më të plotë veç asaj, qi na pruri H. Muhammedi, paqi dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi Të.

Dhe nji prej të mirave Islame, për të cilat na ka shtyë Profeti, A.S., për me i dashtë e me i dëshirue, është edhe kjo që ne duhet të merremi me atë punë, me të cilën të mundemi me mprojtë jetën t’onë si dhe jetën e atyre për të cilët jemi të detyruëm me i mbajtë e me harxhuë për ‘ta.

Le të përpiqemi, prâ, me kambëngulje e pa prâ për me përfituë e me mbërri lumtërinë në jetën e kësaj bote (dhe mandej edhe për tjetrën) dhe të mos bähemi parazitë e mërzi e të tjerëvet!” - (Revista “Kultura Islame”, viti 1, fruer-mars, 1940-XVIII, (Muh.-Safer, 1358), nr. 6-7, f. 267-268 e në vijim)

Këto rreshta plot urti, duket se konvertohen sot, në një thirrje të fortë e shumë aktuale, që sikur na thotë: Zgjohuni, o muslimanë, mësoni nga të Urtët tuaj, shfrytëzojeni kohën, perfeksiononi dituritë, zhvillojeni ekonominë ...

### “MUSLIMANI TË JETË I SHTRËNJTË DHE HIJE-RËNDË DHE JO PARAZIT!”

Hoxha, nëpërmjet kësaj hytbeje, tërheq vëmendjen drejt vlerës së madhe që ka puna e hallallit dhe angazhimi serioz i muslimanëve për ta ndërtuar jetën nëpërmjet sakrificës, larg dembelizmit, parazitizmit, humbjes së kohës dhe mundësive që na dhurohen në jetë.

Mungesa e alternativave për zhvillimin e aftësive intelektuale dhe dhuntive hyjnore, mungesa e politikave për zhvillimin e resurseve natyrore, dëmtimi i pasurive natyrore kombëtare, përhapja në masë e pasigurisë, korrupsionit etj, janë alarme, që duhet të na tërheqin vëmendjen për të mos jetuar si parazitë e të izoluar ndaj detyrimeve që i kemi Zotit, jetës, tokës tonë e vlerave tradicionale kombëtare!

Ja, si shprehet Hafiz Sheuqet Boriçi në vijim të hytbes së tij: [Profeti, Paqi dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi Të, e shfaqë dhe e sqaroi, me të vërtetë, me atë tradisjon të ndershëm e të shënjtë,

se ai qi fiton lumninë e të dy botnavet dhe naltësinat e tyre, është nji njeri, të cilin e preokupoi rrojtja e tij tu u përgatitë mandej me u kthyë edhe në Banimin e Fundit të tij; ai e la në nji anë përtacësinë dhe papunësinë, u përpoq për me mbledh e me fituë ushqimin e tij dhe çdo gjâ tjetër, mbi të cilën qëndron e mbështet jeta e tij dhe ajo e atyre qi mbështeten mbi të e qi për të cilët ai është përgjegjës.

Ai njeri qi përpiqet për me fituë ushqimin e vetvehtes si edhe atë të familjes së tij, do të ketë shpërblimin e nji adhuresi ascetik.

Feja e jonë kërkon punë prej nesh, kërkon që muslimani të jetë i shtrënjtë dhe hije-rëndë dhe jo parazit mbi të tjetët, i poshtë dhe i ofenduem. Kushdo qi e len punën dhe mërzi për me punuë dhe me fituë shujtën e tij, ai e ka humbë shpresën, kështu qi gjendja dhe fundi i tij është rrënim humbje e zhdukje!

Llukmani A.S., i tha të birit: “Merr prej botës atë që mund të mbërrish dhe lene tepricën e fitimit tënd për Botën e Fundit dhe mos e refuzo kohën kryesisht, se bähesh parazit dhe barrë mbi qafët e burrave tjerë!”

Përsëri, i tha: “Kënaqu dhe mjafto me fitimin hallall dhe mos rri në vorfëni, se asnji herë nuk është vorfënuë njeri e qi të mos i kenë râ mbi kryë këto tri vetija: skllavëria në fenë e tij, dobësimi ose ligështimi i mendjes së tij dhe e treta, zhdukja e burrënisë së tij!” - (Revista “Kultura Islame”, viti 1, fruer-mars, 1940-XVIII, (Muh.-Safer, 1358), nr. 6-7, f. 268-269).

### MESATARIZMI DHE RUAJTJA E EKUILIBRAVE NË TRAJTIMIN E KËSAJ BOTE DHE DHE AHIRETIT

Kësaj teme i është qasur edhe Hafiz Sheuqet Boriçi, në ligjërimet e tij. Në vijim të prezantimit të hytbes së tij, dua të ndalem pikërisht tek këshillat e tij të urta, teksa udhëzon, se: [Ai njeri që preokupohet me rrojtjen e tij tue pasë parasyshë edhe Banimin e Fundit të tij, është krejtësisht njeri i vlefshëm. Ndërsa ai qi preokupohet vetëm prej jetesës a rrojtjes, tue heqë dorë prej Jetesës së Fundit, konsiderohet prej njerëzvet të damtuar dhe të humbur!

Ai, i pari është më afër mezatares, ai është prej ekonomëve. Kurse ai, të cilin e preokupon vetëm Jetesa e Fundit dhe nuk i ven veshin Jetesës së kësaj bote, është i mjerë. Sepse cilido që kujton se të lanunit e përpjekjes edhe të mundimit për me fituë shujtën (në këtë botë) është ascetizëm, për të cilin flet Sheriati, gabohet në kujtimin e tij, sepse ascetizmi don me thanë: mos me i dhanë botës kujdesin tënd ma të madh mos mu preokupoë prej saj krejt koha e

jote tue neglizhuë dhe tue lanë kështu mbasdore Ditën tande të Fundit.

Të parët t’onë të mirë në pikpamje besimi, ishin më të fortë dhe më të plotë në vërtetësi se ne, ata mbështeteshin mbi Zotin për të gjitha veprat e tyre, tue pasë besim të plotë ke Ai për çdo gjâ. Megjithë këtë ata i epshin rëndësi rrojtjes së tyre, nuk lejshin asnji udhë të ndershme, qi të çon në fitim, për pa e ndjekun dhe as nji derë të mbyllur për pa u munduë për t’a çelë.

Dhe Omer Ibn-el-Hattabi, Zoti u kënaqtë prej Tij, thoshte: “Le të mos rrijë ndokush për pa kërkue shujtën dhe të kalojë kohën duke thënë: O Zot më nep muë shujtën; ju e dini se qielli nuk hedh as ar as sermë!” - (Revista “Kultura Islame”, viti 1, fruer-mars, 1940-XVIII, (Muh.-Safer, 1358), nr. 6-7, f. 269-270).



### NË VEND TË MBYLLJES...

Ka mjaftueshëm mësimet e udhëzime, sa për të angazhuar njerëzit e fushës, shumë më shumë sesa ka ndodhur deri më sot, me historinë e hoxhallarëve tanë, (që në vështrimin tim, nuk janë studiuar nga njerëzit e duhur dhe, nuk ka dalë në pah madhështia e shpirtit të tyre, sidomos në drejtim të edukimit islam dhe mbrojtjes së interesave të ndershme kombëtare!)

Hafiz Sheuqet Boriçi, (megjithë gjurmët e pakëta të evidentuara deri më sot, si dhe shkrimet e pamjaftueshme, që nuk e kalojnë kufirin e përkufizimit të detajuar shkencor), besoj se është njëri prej hoxhallarëve elitarë të Shkodrës.

Mesazhet e zotnisë së tij, kundër papunësisë, përtacisë, parazitizmit, kamatës, si dhe nxitjes për të jetuar me

dinjitet e me frikën e Zotit!

Hafiz Sheuqet Boriçi, shprehet kështu: “Zoti e mëshiroftë atë njeri qi largohet prej përtacisë dhe papunësisë, shpëton prej mjerimevet dhe prej të fundosmes në baltë, e kryen plotësisht atë qi i kërkon Edukuësi i botnavet; por të kërkuemit duhet të jetë me mirësi sikurëse urdhënon A.S.: “Meleqi më fryni e më sugzhectionoi në mendje, qi asnji shpirt s’ka me vdekë pa plotësuë shujtën dhe kohën e fundit të jetës së tij (exhelin). Pra, ndigjoni dhe bahuni të divotshe ndaj Zotit dhe kërkoheni me mirësi.”

Kuptimi i (kërkoheni me mirësi) d.m.th., kërkoheni shujtën me mirësië, e nuk tha qi mos e kërkoni. Kërkoeni për pa e damtuë fenë, Zoti nuk e bekon nji botë pa fé, sepse, duhet dijtë, se kryët e gjasë së besnikëvet është feja, pra duhet t’a mprojë atë me çdo mënyrë; dhe çdo shkak botnuër qi sheh se e damton fenë e tij duhet t’a largojë...

Kaq mund të kujtohet për shkaqet qi e cenojnë fenë, por nuk e rrënojnë dhe nuk e përbysin prej bazës së saj tanësisht, si për shëmbëll sendet e ndaluëme ligjisht, si Kamata, qi shumë tregtarë e përdorin këtë tue kujtuë se me këtë mënyrë mund të fitojnë. Kjo, është nji cenim i fesë së tyne gjer në fund, dhe është frikë për atë njeri, qi vazhdon në këtë veprim, për pa iu penduë All-llaht (Xhel-le xhelaluhu)... Zoti na rujtë!

Dijetarët, si Ibn Haxheri në librin “Sherhul-Minhaxh”, thonë se Zoti i Madh, s’ka përmendur në Kuran ndonji mëkat qi të jetë luftë, për të zotin e tij, veç Kamatës...

O robët e Zotit, kini frikë Zotin dhe pranoni këshillat, pendohi te Zoti për keqveprimet, plotësisht, se keqbërësit e mëkatnorët hyjnë në Skëterrë...

### H. Sheuqet Imam e Hatib i xhamisë Sulltan Bajazit d.v”

(Revista “Kultura Islame”, viti 1, fruer-mars, 1940-XVIII, (Muh.-Safer, 1358), nr. 6-7, f. 270-271).

All-llahumme pranoje këtë këshillë të urtë dhe këtë hytbe plot udhëzim e mirësi nga Hafiz Sheuqet Boriçi dhe lartësoje mekamin e tij në ditën e gjykimit, ja All-llah! Amin!

**Imam Muhamed B. Sytari**

Myfti i Zonës Shkodër



**Naim Driaj**  
Imam, xhamia Parrucë

**N**jeriu nuk do të kishte vlerë po të mos ishte dituria. Zoti (xh.sh) na këshillon që të mos bëhemi nga të paditurit.<sup>1</sup> All-llahu i Madhëruar thotë: "Thuaj: "A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?!"<sup>2</sup>

Zoti (xh.sh) thotë: "All-llahu do t'i ngrejë në shkallë të larta ata, të cilët besuan prej jush dhe atyre të cilëve iu është dhënë dija."<sup>3</sup> Nga mirësitë e All-llahut është se Ai nuk e ka vendosur diturinë në një person të veçantë dhe as në ndonjë fis të caktuar. Ajo është mirësi e All-llahut që ia dhuron kujt të dojë në mënyrë që njerëzit të garojnë në arritjen e saj.

All-llahu nuk e ka urdhëruar të Dërguarin e Tij që të kërkonte shtimin e diçkaje, përveç diturisë.

"O Zoti im, ma shto diturinë!"<sup>4</sup> All-llahu (xh.sh) e nisi Kur'anin Fisnik me urdhrin e shenjtë: "LEXO". "Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (çdo gjë)!"<sup>5</sup> Urdhri hyjnor "LEXO" nuk i drejtohet vetëm Pejgamberit (a.s) personalisht, por i drejtohet të gjithë ymetit musliman.

Prandaj Profeti (a.s) në shumë hadithe ftoi për dituri. Ai thoshte, se i dituri është më afër All-llahut. "Dijeni o njerëz, se All-llahu i Madhëruar, melekët e Tij, banorët e qiejve dhe të tokës, milingona në folenë e saj dhe peshku në thellësinë e detit, luten për mësuesin, që u mëson njerëzve mirësinë."<sup>6</sup>

**Dituria është bazë e çdo mirësie dhe burim i çdo virtyti.**

Fjala dituri përmendet në Kur'anin Famëllartë më shumë se në 600 ajete.

1. Kur'ani, Hud: 46.
2. Kur'ani, Ez- Zumer: 9.
3. Kur'ani, El-Muxhadele: 11.
4. Kur'ani, Ta-Ha: 114.
5. Kur'ani, El-Alak: 1.
6. Transmetuar nga Tirmidhiu, nr.2685.

## DISA KËSHILLA NË PRAG TË FILLIMIT TË VITIT TË RI SHKOLLOR 2017-2018

Leximi përmendet në Kur'an në 17 ajete.

Recitimi përmendet në Kur'an në 68 ajete.

Shkrimi përmendet në Kur'an në 300 ajete.

Lapsi përmendet në Kur'an në 4 ajete.

All-llahu (xh.sh) e ka hapur suren El-Kalem me një betim hyjnor për mjetin e të shkruarit, penën dhe gjithçka që shkruhet me të.

Fletët (fletushkat) përmenden në Kur'an në 8 ajete.

Rreshti përmendet në Kur'an në 5 ajete.

Mësimi përmendet në Kuranë në 6 ajete.

Imam Ahmed (All-llahu e mëshiroftë) ka thënë: "Njerëzit kanë nevojë më shumë për t'u pajisur me dituri, sesa të pajisen me ushqim dhe pije. Sepse për ushqim njeriu gjatë ditës ka nevojë vetëm një apo dy herë, kurse për dituri njeriu ka nevojë deri në çastin e vdekjes".

1- Nxënësi i dijes duhet të jetë i sigurt dhe të ketë qëllim të mirë në kërkimin e diturisë. Imam Ahmed ibn Hanbeli (All-llahu e mëshiroftë) e këshillonte të birin e tij me këto fjalë: "Biri im! Rregulloje njetin (qëllimin) tënd sepse po e rregullove njetin do t'i kesh punët mirë me All-llahun.

2- Nxënësi i dijes nuk duhet të harrojë se arritja e diturisë bëhet përmes dy gjërave, të cilat duhet të ecin së bashku njëra me tjetrën:

**E para:** Qëndrimi para mësuesit, profesorit, edukatorit. Kërkuesi i dijes përparon atëherë kur është nën përkujdesjen e një mësuesi. Patjetër nxënësi i dijes duhet të ketë lidhje me një mësues që i zgjidh problemet që has gjatë kërkimit të diturisë. All-llahu (xh.sh) po të donte do ia mësonte përmendësh Kur'anin Profetit (a.s) në mendjen e tij pa pasur nevojë për Xhibrilin (a.s).

Abdullah ibn Mesudi (r.a) ka thënë: "Kam mësuar nga goja e Pejgamberit (a.s) 70 sure të Kur'anit".

**E dyta:** Leximi, të jetuarit me librin. "Leximi për mendjen është sikur sporti për trupin".

**"NJERIU ËSHTË NË FENË E SHOKUT TË TIJ, PRANDAJ LE TË SHIKOJË NJERIU SE KË KA PËR SHOK"**

Dija është shkallë-shkallë dhe nuk arrihet në shkalla të larta vetëm se përmes leximit, angazhimit, lodhjes dhe pagjumësisë. Kur është pyetur Imam Ahmed se deri kur do të merresh me shkrim dhe me lexim, ka thënë: "Deri në vdekje!"

3- Nxënësi i dijes së pari duhet të fillojë të mësojë gjërat e thjeshta pastaj detajet e tyre.

4- Interesimi për njerëzit e dijes duke i pyetur ato. All-llahu (xh.sh) thotë: "Pyetni dijetarët nëse nuk dini."<sup>7</sup> Për këtë arsye Xhibrili (a.s) erdhi si mësues tek sahabët, duke u ulur në gjunjë pranë Profetit (a.s), duke i afruar gjunjët e tij me të Profetit dhe duart e tij mbi gjunjët e Profetit, më pas e pyeti. (Pyetja bëhet për dy qëllime ose për të mësuar ti diçka ose për të përfutur të tjerët nga pyetja jote).

5- Nxënësi i dijes duhet të jetë këmbëngulës dhe durimtar në kërkimin e diturisë. Ai duhet të japë të gjithë mundin e tij në kërkim të diturisë që dituria t'i japë atij aq sa meriton. Nxënësi i dijes duhet të ndjekë të gjitha rrugët e mundshme për të arritur dijen dhe për këtë ai ka shpërblim tek All-llahu. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "All-llahu ia lehtëson rrugën për në xhenet muslimanit që merr rrugën për të nxënë dituri".<sup>8</sup>

Sufjan ibn Ulejje ka thënë: "Ai i cili e kërkon diturinë ia ka dhënë besën All-llahut." Kërkimi i diturisë është i vështirë, mirëpo vështirësitë në këtë rrugë janë të këndshme dhe të ëmbla pasi dituria nuk arrihet përpos se me lodhje dhe mundime. Durimi ka si shpërblim xhenetin, All-llahu (xh.sh) thotë: "Paqe për ju, për durimin që keni treguar..."<sup>9</sup> Prandaj, duro! Se, me të vërtetë, në fund, fitorja është e besimtarëve (durimtarëve)."<sup>10</sup>

6- Nxënësi i dijes duhet të ketë

7. En-Nahl, 43
8. Muslimi
9. Er-Ra'd, 24
10. Hud, 49

ambicie në kërkimin e diturisë. Ambicia në kërkimin e diturisë është një prej gjërave themelore që kërkohet nga nxënësi. I Dërguari i All-llahut (a.s) ka thënë: "Kur dikush nga ju të kërkojë nga All-llahu, le të kërkojë xhenetin e lartë të Firdeusit"<sup>11</sup>.

7- Nxënësi i dijes duhet të bëjë kujdes se me ke shoqërohet. Profeti (a.s) ka thënë: "Njeriu është në fenë e shokut të tij, prandaj le të shikojë njeriu se kë ka për shok".<sup>12</sup> Sufjan Theuriu ka thënë: "Për njeriun nuk ka dëm e as dobi më të madhe, sesa shoku". Imam Shafiu (All-llahu e mëshiroftë) ka thënë: "Nuk vjen gjë e mirë prej atij që nuk e do diturinë. Prandaj, mos u miqëso me një njeri të tillë, sepse dituria është jeta e zemrave dhe pishtari i arsyes".

8- Nxënësi i dijes duhet të bëjë kujdes për kohën dhe shfrytëzimin e saj. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Dy prej begative, shumica e njerëzve nuk ia dinë vlerën: shëndetit dhe kohës së lirë."<sup>13</sup> "Koha është gjëja më e shtrenjtë që duhesh të kujdesesh për të, ndërsa është gjëja më e lehtë që mund të humbasësh." Hasan el- Basriu (r.a) ka thënë: "Kemi takuar disa njerëz që kanë qenë më të kujdesshëm ndaj shfrytëzimit të kohës sesa ju ndaj dinarit e dirhemit."

9- Prindërit duhet të jenë vazhdimisht në kontakt me mësuesit dhe në veçanti më mësuesin kujdestar.

E lus All-llahun që mësuesit e sotëm ta vlerësojnë punën e tyre dhe të mos e shikojnë atë thjesht si mjet jetese por le ta shikojnë punën e tyre si kontributin më të mirë që mund të japin për shoqërinë dhe si një rrugë për xhenet.

Një nga punët që nuk humbet edhe pas vdekjes së njeriut, është kontributi në dituri. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Një nga punët që vazhdon ta çojë sevapin tek robu edhe pasi ai ka vdekur, është dituria që ai ka lënë pas dhe nga e cila përfitojnë njerëzit".<sup>14</sup>

E lus All-llahun të na mësojë atë, që është më e mira për ne dhe të na japë dobi prej diturisë që kemi mësuar.

E lus Zotin ta përmirësojë situatën e popullit tonë, që rinia t'i drejtohet arsimit dhe të largohet nga veset e këqija dhe çdo gjë e dëmshme për vete, familjen dhe vednin.

11. Transmetuar nga Ebu Nuejm El-Esbahani.
12. Transmetuar nga Ebu Davudi, nr. 4833. Tirmidhiu, nr. 2378.
13. Transmetuar nga Buhariu.
14. Transmetuar nga Muslimi, nr. 1631.

## HAFIZ SHEUQET BORIÇI (1884-1965)

**Q**ytyti i Shkodrës është shquar në të kaluarën për tradita të mira atdhetare, fetare e kulturore, prej aty kanë dalë figura të shquara në përpjekjet për të mbrojtur interesat kombëtare, për të zhvilluar edukatën fetare dhe për të rritur nivelin arsimor e kulturor të popullit. Një figurë e tillë ka qenë dhe Hafiz Sheuqet Boriçi.

Hafiz Sheuqeti, i biri i Musa Boriçit dhe kushëriri i parë i patriotit të njohur të Rilindjes Kombëtare Daut efendi Boriçit, lindi në qytetin e Shkodrës më 1884 në një mjedis me tradita atdhetare e fetare. Përfundoi me rezultate të shkëlqyera shkollën qytetëse dhe medresenë më 1910.

Duke qenë i 9-ti brez hoxhë në fisin e tij, ai kishte dëshirë të madhe për t'u pajisur me kulturë të gjerë të përgjithshme fetare dhe për këtë ai mësoi te H. Hafiz Jusuf Këlmendi, Haxhi Vehbi Dibra etj. Nga mungesa e literaturës shqipe iu vu mësimi të gjuhëve të huaja, duke zotëruar mirë arabishten, osmanishten dhe persishten.

Hafiz Sheuqeti ka trashëguar një bibliotekë të rrallë për kohën e vet me shumë libra me karakter fetar dhe shkencor, të cilën e pasuronte vazhdimisht me libra të rinj. Në bibliotekën e tij gjendeshin libra të rrallë, e shumë të vjetër (shkruar me dorë), që flisnin për mjekësinë, matematikën, astronominë etj. Ai përdorte me aftësi të dhënat astronomike për të përcaktuar saktë orët e kohëve të ditës në muajin e ramazanit.

Bibliotekën e tij aq të pasur e përvetësoi dhe e shkatërroi regjimi monist, ashtu siç ndodhi me bibliotekat e të gjithë hoxhallarëve të tjerë në vitin 1967.

Hafiz Sheuqet Boriçi gjatë gjithë jetës së tij ka zhvilluar një veprimtari të pandërprerë në shkollë e lagje të ndryshme të qytetit të Shkodrës. Ka qenë mësues në shkollën Irfan (normale, për të nxjerr mësues), po kështu mësues besimi në shkollën e Perashit (1916-1924) dhe imam në xhaminë e Perashit. Kohët e fundit ka qenë vaiz ku ka dhënë vasë në xhaminë e Parrucës e të Fushë Çelës në qendër të qytetit. Ai ishte orator, me një të folur të qartë, të saktë, me një tingëllim të ëmbël dhe me një fjalor të zgjedhur e të kuptueshëm.



Si fetar, Hafiz Sheuqeti nuk u mor drejtpërdrejt me politikë, por si atdhetar e demokrat që ishte nuk u pajtua me veprimet antipopullore. Për këtë ai qëndroi në opozitë të hapur e të heshtur me regjimin e Zogut, me pushtimin fashist e me diktaturën moniste komuniste.

Në qershor 1924 u kërkua nga populli mbajtja e një vase në xhaminë e Parrucës ku ndër të tjera përmendi një ajet kur'anor, duke vënë në dukje se gjakderdhja, vëllavrasja në besimin Islam janë të ndaluara.

Edhe në regjimin e diktaturës moniste në raste të ndryshme gjatë vasës theksonte rëndësinë e fesë dhe fliste për të drejtat elementare të njeriut, demaskonte diktaturën dhe shfaqte optimizëm për të ardhmen demokratike që e priste Shqipërinë. Në sajë të formimit të tij si erudit i madh me një veprimtari të gjerë të personalitetit dhe të karakterit të tij të lartë. Ai me kohë fitoi simpati dhe respekt të thellë në popull.

Një shprehje e nderimit që ushqej për të ishte dhe pjesëmarrja jashtëzakonisht e madhe e popullit në varrimin e tij në vitin 1965 duke u ndarë nga dashamirësit e tij dhe besimtarët e shumtë në moshën 81 vjeçare.

Në vitin 1994 Hafiz Sheuqet Boriçi është dekoruar nga Presidenti i Republikës, Sali Berisha.

(Nga enciklopedia: "100 Personalitete shqiptare të kulturës islame", botim i KMSH, Tiranë 2012)



Durim Kasemi

Imam, xhamia Parrucë

Përfillet shpeshherë se Islami i ka bërë padrejtësi femrës në çështjen e trashëgimisë kur ka vendosur t'i japë mashkullit dyfishin e pjesës që merr femra. Por, ky përgjithësim nuk është aspak i saktë sepse, çështja e trashëgimisë së femrës nuk është ashtu sikur paraqitet, sikur femra merr më pak se mashkulli çdoherë, sepse kjo është një pjesë shumë e vogël e rasteve, që merr femra në trashëgimi siç edhe do ta dëshmojmë në vijim.

Për hir të së vërtetës, ekzistojnë qëndrime të padrejta ndaj femrës nga disa muslimanë dhe shoqëri muslimane, të bazuara në tradita e zakone, apo keqkuptime të Islamit, të cilat kanë nxitur urrejtjen dhe kanë ndihmuar në qëndrimet negative e armiqtësore ndaj tij, por që nuk kanë të bëjnë me Islamin, si sistem jete.

Temën e trashëgimisë së femrës e kanë trajtuar shumë dijetarë dhe hoxhallarë nga këndvështrime të ndryshme, në libra dhe studime të veçanta, por gjithashtu edhe si pjesë të shkrimeve të ndryshme, ku ndër më të spikaturit, ndër këto studime, është ky studim i Dr. Salahuddin Sultan, Egjipt.

Libri, "Trashëgimia e femrës dhe çështja e barazisë" i autorit dr. Salahuddin Sultan, i cili përmban 56 faqe dhe ndahet në katër kapituj, botuar në Kajro, në vitin 1999, botimi i parë, nga shtëpia botuese "Nehdatu Misr", me parathënie të dr. Muhammed Amareh.

Libri edhe pse i vogël në vëllim, ka një vlerë shumë të madhe për nga përmbajtja. Ai e trajton çështjen e trashëgimisë së femrës, në një mënyrë që nuk është trajtuar më parë, duke mbledhur së bashku të gjitha rastet kur femra merr pjesë dhe, duke nxjerrë në pah pjesën dhe sasinë që merr ajo, duke hedhur poshtë spekulimet se femra merr

## TRASHËGIMIA E FEMRËS DHE ÇËSHTJA E BARAZISË

gjysmën e asaj që merr mashkulli në trashëgimi në të gjitha rastet.

Pas studimit të të gjitha rasteve, ku femra merr pjesë nga trashëgimia, autori ka konstatuar se: **Në katër raste** femra merr sa gjysma e pjesës së mashkullit. **Në tetë raste** të tjera femra merr të njëjtën sasi sikur mashkulli. **Në dhjetë raste** të tjera femra merr më shumë se mashkulli. Kurse në disa raste të tjera femra merr pjesë, ndërsa mashkulli nuk merr fare pjesë nga trashëgimia.

Për të kuptuar më qartë dhe më mirë çështjen e trashëgimisë së femrës, është shumë e rëndësishme të dihen detyrimet financiare që ka mashkulli dhe

femra në familje, sipas filozofisë legjislativë islame. Femra në të gjitha fazat e jetës së saj, vajzë, bashkëshorte, nënë dhe gjyshe, nuk ka asnjë detyrim financiar kundrejt pjesëtarëve të tjerë të familjes. Në të kundërt, mashkulli, djalë, bashkëshort dhe prind, i ka mbi supe të gjitha detyrimet financiare, kundrejt pjesëtarëve të tjerë të familjes, siç janë prindërit, fëmijët, bashkëshorten, etj. Kuptimi i kësaj çështjeje eliminon shumë paqartësi dhe keqkuptime në lidhje me trashëgiminë e femrës në Islam.

Përpara se të fillojmë të shpallim rastet kur femra merr nga trashëgimia, do përmendim disa parime bazë mbi të cilat ngrihet filozofia e Islamit në lidhje me trashëgiminë, në veçanti, por edhe në rregullat e përgjithshme të saj në përgjithësi, që të kuptohet më mirë çështja e trashëgimisë së femrës.

E drejta e trashëgimisë dhe sasia e saj nuk bazohet në gjininë e trashëgimtarit, por në tre parime të cilët janë:

Afërsia e trashëgimtarit me trashëgimlënësin, kështu që sa më e afërt të jetë lidhja familjare, aq më e madhe është sasia e fituar me trashëgimi.

Renditja dhe pozicioni për nga mosha e trashëgimtarit, ndër trashëgimtarët e tjerë. Nisur nga kjo, personat që janë në moshë të re në përgjithësi marrin më shumë se sa personat e moshuar

dhe që kanë kaluar një pjesë të mirë të jetës tyre sipas ligjeve që ka caktuar Allahu, pa marrë parasysh gjininë e trashëgimtarit. Për shembull, vajza merr më shumë se nëna edhe pse të dyja janë femra, madje mund të marrë edhe më shumë se babai. Gjithashtu edhe djali merr më shumë se babai edhe pse të dy janë meshkuj.

Detyrimet financiare të trashëgimtarit të sanksionuara nga Allahu Fuqplotë dhe Ligjvënësi absolut, që ka personi ndaj të tjerëve. Ky është kriteri bazë që shkakton në disa raste ndryshimin në përqindje, mes mashkullit dhe femrës. P.sh, kur



Allahu thotë në suren Nisa, ajeti 11: "Allahu ju urdhëron që në trashëgimi, fëmijëve tuaj t'i jepni, meshkujve sa dyfishin e femrave...". Në këtë rast mashkulli, vetëm djali konkretisht, merr dyfishin e femrës, motrës, sepse ai në këtë rast edhe pse në një shkallë të njëjtë afrimiteti me të vdekurin, sikur edhe motra, gjithashtu edhe nga mosha dhe brezi, të cilit i përket janë të njëjtë, është i ngarkuar nga Allahu Fuqplotë me detyrime financiare ndaj personave të tjerë të mbetur në shtëpi, siç janë: bashkëshortja, nëna, motra etj, ndryshe nga femra, e cila nuk ka asnjë detyrim financiar kundrejt askujt. Nisur nga këto parime, e ka dalluar Islami femrën nga mashkulli në trashëgimi, e jo nga përkatësia gjinore e saj.

Rastet kur femra merr sa gjysma e pjesës së mashkullit

Pas një studimi të të gjitha rasteve, ku femra merr sa gjysma e pjesës së mashkullit, vërejmë se kjo ndodhë vetëm në katër të tillë:

Nëse vajza trashëgon bashkë me djalë:

Kështu që, nëse personi vdes dhe si trashëgimtarë ka një djalë dhe një vajzë, atëherë trashëgimia ndahet në tri pjesë dhe djali merr 2\3, ndërsa vajza 1\3. Kështu veprohet edhe nëse numri i fëmijëve është më i madh.

Të ngjashëm me këtë janë edhe rastet kur trashëgimtarë janë nipërit dhe mbesat në mungesë të prindërve të tyre (djemtë dhe vajzat e të vdekurit).

Kur bashkohen babai dhe nëna dhe i vdekuri nuk ka as fëmijë dhe as bashkëshort, apo bashkëshorte:

Në këtë rast trashëgimia ndahet në tri pjesë dhe nëna merr 1\3, ndërsa babai merr pjesën e mbetur që është 2\3.

Për këtë, Allahu thotë në Kur'an: "... dhe nëse i vdekuri nuk ka fëmijë dhe trashëgimtarë ka vetëm prindërit e tij, në këtë rast nëna merr një të tretën...". Në lidhje me këtë rast, Pejgamberi (a.s) thotë: "Jepjani trashëgiminë atij që i takon dhe çfarë mbetet t'i marrë mashkulli më i afërt". (Buhariu: 6732)

Kur bashkohet motra nga nëna dhe babai me vëllanë nga babai dhe nëna ose motra nga babai:

Kështu që, nëse personi vdes dhe ndër trashëgimtarët e tij janë motra dhe vëllezër nga babai dhe nëna apo vetëm nga babai, në këtë rast vëllezërit marrin dyfishin e motrave. Për këtë, Allahu thotë në Kur'an: "... e nëse trashëgimtarët janë vëllezër dhe motra, atëherë mashkulli merr dyfishin e femrës...". (Nisa: 176)

Në rast se vdes bashkëshorti, apo bashkëshortja pjesa që marrin është:

Nëse nuk kanë lënë fëmijë, bashkëshorti merr 1\2 dhe bashkëshortja 1\4. Ndërsa, nëse ka lënë fëmijë, bashkëshorti merr 1\4, dy pjesë dhe bashkëshortja 1\8, një pjesë. Siç shihet në këtë rast, mashkulli merr dyfishin e femrës.

Për këtë Allahu thotë në suren Nisa, ajeti 12: "Juve ju takon gjysma e asaj (pasurie) që e lënë gratë e juaja, nëse ato nuk kanë fëmijë, por nëse ato kanë fëmijë, juve ju takon një e katërta nga ajo që lënë ato, pasi të kryhet testamenti i tyre dhe pasi të lahet borxhi. Atyre (grave) u takon një e katërta nga ajo që lënë ju, nëse nuk keni fëmijë, por nëse keni fëmijë, atyre u takon një e teta nga ajo që leni, pas kryerjes së testamentit që keni përcaktuar ose borxhit". (Vijon)

## HISTORIA E XHAMISË SË DY KIBLEVE

Disa mendjelehtë (nga ithtarët e Librit) do të thonë: "Ç'i ktheu ata prej kiblës së tyre?" Thuaju: "Të Allahut janë Lindja dhe Perëndimi. Ai udhëzon kë të dojë në rrugën e drejtë". (Kur'ani, 2:142)

Thuajse 18 muaj pas themelimit të shtetit islam në Medinë, shpalljet e reja kur'anore e udhëzuan Profetin (a.s) dhe muslimanët që të ktheheshin drejt Qabes gjatë faljes, ndryshe nga ç'kishin vepruar deri në atë çast kur ktheheshin nga xhamia Al-aksa në Jeruzalem.

Para se të ndryshonin Kiblën (që në arabisht nënkupton drejtimin për nga Qabja, xhaminë e shenjtë të Islamit) Profeti Muhamed (a.s) ishte përgjërur me zemër që fytyra e tij të drejtohej nga Qabja ndërsa falej. Në përgjigje të lutjes së tij, Allahu i Gjithëfuqishëm urdhëroi ndryshimin e Kiblës, nga Jeruzalemi në Mekë.

"Ne të pamë ty (Muhamed) që vazhdimisht drejtoje shikimin nga qielli. Mirë pra, Ne do të të kthejmë ty nga kibla që të kënaq ty. Prandaj, ktheje fytyrën tënde nga Xhamia e Shenjtë (Qabeja)! Dhe kudo që të gjendeni, kthejeni fytyrën tuaj nga ajo anë! Pa dyshim, ata që u është dhënë Libri (Teurati), e dinë se drejtimi nga Qabeja është e vërteta prej Zotit të tyre. Allahu nuk është i pakujdesshëm ndaj punëve që ata bëjnë." (Kur'ani, 2:144)

Kjo ndodhi në mes të muajit të Shabanit.

### Historia e Xhamisë së dy Kibleve

Emri i kësaj xhamie lidhet me ngjarjen e ndryshimit të kiblës. Profeti



Muhamed a.s ishte duke udhëhequr faljen kur i mbërriti shpallja nga Allahu, që e udhëzonte të përdorte Qaben si drejtim (kible).

Sipas transmetimeve të gjithë pranuar, Profeti Muhamed (a.s), që ishte drejtuar me fytyrë nga Jeruzalemi gjatë faljes, sapo i zbriti shpallja, e ktheu menjëherë fytyrën nga Meka, ndërkohë që edhe ata që po faleshin pas tij bënë të njëjtën gjë. Pas kësaj, xhamia ku u zhvillua kjo ngjarje u bë e njohur në traditën popullore si Xhamia e Dy Kibleve.

Xhamia e Dy Kibleve, ndryshe nga çdo xhami tjetër në botë, kishte dy mihrahe, një në drejtimin e xhamisë Aksa dhe tjetrin në drejtim të Mekës. Megjithatë, mihrabi i vjetër më vonë u hoq.

Shumë pelegrinë që shkojnë të kryejnë haxhin në Mekë, pas e përfundojnë atë shkojnë edhe në Medinë, ku vizitojnë edhe Xhaminë e Dy Kibleve për shkak të domethënies së saj historike.

(www.breziiri.com)





## MYFTIU TAKOI IMAMËT E QYTETIT PËR PROGRAMIN E RI TË DERSEVE

**P**araditën e së enjtes, më 14 shtator 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me imamët e qytetit, me të cilët diskutoi për disa çështje, që lidhen me mbarësinë e aktivitetit fetar në shërbim të Thirrjes Islame.

Fillimisht, Myftiu falënderoi imamët për shërbimet e tyre, duke vlerësuar ceremoninë e Kurban Bajramit në shesh, si dhe përkujdesjen e tyre për afrimin e rinisë në xhami.

Në rend të ditës ishte edhe programi i ri i derseve javore, për të cilin, Myftiu tha se është e domosdoshme, që në të gjitha xhamitë e Shkodrës të ketë derse të përjavshme, në mënyrë që besimtarët të kenë alternativa dhe mundësi të shumta përftimi dhe kontaktesh të përditshme me imamët e shumtë, prej të cilëve duan dhe mund të përfitojnë.

Myftiu vlerësoi iniciativat e mëparshme dhe projektet e shumta sezonale, që Myftinia Shkodër ka



ndërmarrë gjatë viteve në këtë kontekst dhe konfirmoi domosdoshmërinë e disiplinimit dhe konsolidimit të këtij programi.

Imamët e nderuar ishin të një mendjeje për vlerën e këtyre derseve, sikurse shprehën gatishmërinë për të dhënë kontributin e tyre për mbarësinë e tij.

Shumë shpejt, Myftinia Shkodër do të bëjë publike listën e derseve të përjavshme që do të zhvillohen në xhamitë e Shkodrës, duke nisur nga dita e sotme, ku Myftiu do të rinisë dersin e tij javor në xhaminë e Tophanës, pas namazit të akshamit.

## SË SHPEJTI NISIN PUNIMET PËR XHAMINË E MADHE NË OBLIKË

**P**araditën e së martës, më 19 shtator 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim pune përfaqësuesit e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Agron Hoxha dhe z. Gëzim Shahu, në kuadër të iniciativës

për ndërtimin e xhamisë së madhe në Oblikë, Ana e Malit.

Myftiu theksoi se çdo përpjekje për rinovimin e xhamive të vjetra dhe zëvendësimin e tyre me komplekse të reja shumëfunktionale, në shërbim të besimtarëve dhe qytetarëve, janë të

mirëpritura dhe të domosdoshme.

Ai vlerësoi iniciativën e Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Skender Bruçaj në këtë drejtim, sikurse falënderoi angazhimin e z. Agron Hoxha në këtë ndërmarrje të dobishme.

**D**itën e martë, më 19 shtator 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një inspektim në terren për të parë nga afër pronën vakëf në lagjen Draçin.

Myftiu theksoi se kthimi në identitetin i vakëfeve të shumta që kanë mbetur peng shumëvjeçar i burokracive të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, mbetet një prioritet i Myftinisë Shkodër, që duhet mbështetur fuqishëm nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë dhe institucionet e tjera të përfshira në këtë proces.

Ai tha se shumë prona janë zaptuar falë burokracive të institucioneve shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe zaptimeve të papërgjegjshme që kanë ndodhur pas vitit 1990.

Myftiu konfirmoi vullnetin për

## MYFTIU INSPEKTOI VAKËFIN E DRAÇINIT



ndërtimin e xhamisë së re në Draçin, (edhe si kërkesë e vazhdueshme e besimtarëve) në të njëjtin vend ku ishte para vitit 1967, kur xhamitë dhe pronat vakëf të muslimanëve u shkatërruan dhe

u tjetërsuan nga kriminelët komunistë, e megjithëse kanë kaluar 27 vjet nga rilejimi i fesë, akoma nuk po i kthehen Myftinisë së Shkodrës.

## MYFTIU FOLI PËR PËRJETIMET E HAXHIT TË SIVJETSHËM

**D**itën e xhuma, më 22 shtator 2017, nëpërmjet një bashkëbisedimi në Star Plus Tv, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, foli mbi përjetimet dhe përvojën e kaluar gjatë ditëve të Haxhit të sivjetshëm.

Fillimisht, Myftiu uroi krejt haxhilerët e këtij viti dhe familjarët e tyre për këtë mirësi të madhe, që e konsideroi si bekim edhe për Shkodrën dhe mbarë Shqipërinë.

Ai tha se pa asnjë dyshim, udhëtimi në vendet e shenja, mbetet "udhëtimi i jetës", për këdo që i është mundësuar kryerja e Haxhit apo Umres.

Myftiu tha se mbi tre mijë shqiptar nga mbarë trojet tona dhe diaspora, ishin atje, në më të mirat vende të botës, duke dëshmuar faktin se shqiptarët i kanë qëndruar besnikë fesë islame dhe se mësimet dhe shpirtin e tij, ata e kanë kthyer në model jete, që shihet shumë bukur në ditët e Haxhit.



Ai përmendi se, përjetimet e Haxhit janë të papërshkrueshme dhe se çdo haxhi ka momente të shumta, nëpërmjet të cilave ai shijon bukurinë dhe ëmbëlsinë e adhurimit para Qabes, në Arefat, në Mina, në Muzdelife, në Medine dhe shumë e shumë stacione të tjera, ku përtëritet besimi dhe shtohet dashuria

për All-llahun dhe të Dërguarin e Tij.

Myftiu konfirmoi se ditën e Arefatit janë bërë lutje të shumta edhe për Shkodrën dhe Shqipërinë, besimtarët dhe qytetarët e këtij vendi, që ky vend të kthehet nga besimi dhe të gjejë qetësinë dhe mirëqenien në hapësirat e tij.

## "HISTORIA E KALENDARIT ISLAM", NË FILLIMVITIN E RI 1439 H.

**M**brëmjen e së mërkurës, më 27 shtator 2017, në xhaminë e "Dy Vajzave", imami i saj, teologu Lavdrim Hamja mbajti një ligjëratë të dobishme mbi historikun e formimit të kalendarit hixhri.

Me fillimin e vitit të ri hixhri, që nis me muajin Muharrem, u pa me vend zhvillimi i kësaj ligjërate për të informuar të interesuarit për lidhjen e ngjarjes së Hixhretit me formimin e kalendarit islam.

Ligjëruesi përmendi edhe vlerën e madhe historike, fetare, morale dhe shoqërore të udhëtimit nga Meka në Medine të muslimanëve me të dërguarin e All-llahut, si dhe domosdoshmërinë e kuptimit të shpirtit të Hixhretit në jetën e përditshme të çdo muslimani.

Nëpërmjet videoprojektorit, imami i nderuar shpjegoi etapat nëpër të cilat kaloi formimi i kalendarit tonë, debatet në mesin e sahabëve dhe domethënien shkencore të përlllogaritjes me anë të hënës.

Ai tha se ymeti islam i mbështetet këtij kalendarit për kryerjen e krejt adhurimeve; fillimin dhe mbarimin e agjërimit, haxhin, zekatin, kohët e namazeve etj.



## IMAMËT, TAKIM PËR GJALLËRIMIN E AKTIVITETIT FETAR

**P**araditën e së martës, më 3 tetor 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me një grup imamësh të qytetit dhe fshatit, me të cilët diskutoi rreth gjallërimit të aktivitetit fetar në qytet dhe fshat.

Gjatë takimit, Myftiu vlerësoi angazhimet e imamëve, duke theksuar se amaneti i bartjes së Thirrjes Islame tejkalon të gjitha vështirësitë, pengesat, sfidat dhe llogaritë e tjera jashtë saj.

U diskutua plan-programi i ri i lëvizjes sezonale të hatibëve për hytben e xhumasë, ku u pasqyrua grupi i parë i xhamive të përfshira në të.

Duke nisur nga e xhumaja e ardhshme, për një periudhë pesë javore, Myftinia Shkodër, ka planifikuar qarkullimin e



imamëve teologë për të mbajtur hytben e xhumasë në xhamitë e fshatrave: Mjedë, Boks, Milan/Rrasek, Trush, Rragam, Ganjollë, Shtuf dhe Fshati i Ri.

Programi i qarkullimit të hatibëve në kuadër të gjallërimit të aktivitetit fetar në xhamitë e Shkodrës do të përfshijë të gjitha xhamitë e fshatrave të Shkodrës.

## MYFTIU VIZITOI IMAMIN E XHAMISË URA E SHTRENJTË, H. SELIM SYKJA



**P**araditën e së enjtes, më 5 tetor 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, bëri një vizitë në shtëpinë e imamit të nderuar, H. Selim Sykja.

Imami 85 vjeçar është kujdestar dhe shërbyes i zellshëm i xhamisë së fshatit Ura e Shtrenjtë, Postribë që në momentin e parë të ndërtimit të saj, si dhe në mënyrë sistematike nga viti 2002 e deri në vitin 2016.

Ai ka kryer me shumë pasion dhe përkushtim detyrën e imamit, hatibit dhe edukatorit fetar për dhjetëra fëmijë frekuentues të rregullt të kurseve fetare të kësaj xhamie, deri para disa muajsh,

kur u tërhoq nga shërbimet e rregullta për shkak të një lëngate shëndetësore.

Myftiu shprehu vlerësimet dhe mirënjohjen e tij personale dhe të Myftinisë Shkodër për të nderuarin, H. Selim Sykja, duke theksuar angazhimet e tij të sinqerta dhe vullnetare, në shërbim të Fjalës së All-llahut dhe fesë së Tij.

Ai i dorëzoi imamit të përkushtuar, H. Selim Sykja, Certifikatën e Mirënjohjes së Myftinisë Shkodër, duke theksuar se i është mirënjohës shembullit të njerëzve të përkushtuar për fenë islame, si z. Selim Sykja; përherë i gatshëm për të shërbyer, komunikues me besimtarët, njeri fisnik, edukator, i papërtueshëm për të shërbyer

në dobi të vlerate të Thirrjes Islame.

Nga ana e tij, H. Selim Sykja, nuk i fshehu dot emocionet për këtë vizitë dhe vlerësimin e Myftinisë Shkodër, sikurse ndau me Myftiun mendimet dhe porositë e tij për zhvillimin e mëtejshëm të aktivitetit të xhamisë dhe ecurinë e rregullt të tij.

Ai u lut për ecurinë e aktivitetit të Thirrjes Islame dhe gjallërimin e tij përherë e më shumë, sikurse falënderoi Myftiun dhe Myftininë Shkodër për vlerësimin.

Në këtë vizitë, Myftiu shoqërohej edhe nga imamët e nderuar, Lavdrim Hamja, Ervil Kuçi dhe Shkëlqim Sykja.

## U PËRKUJTUA VEPRA DHE AKTIVITETI I HOXHËS HAFIZ SHEUQET BORIÇI



**P**asditën e së xhumasë, më 6 tetor 2017, Myftinia Shkodër organizoi në ambientet e bibliotekës së qytetit një aktivitet përkujtimor në nderim të veprës dhe aktivitetit të Hoxhës së nderuar shkodran, Hafiz Sheuqet Boriçi (1884-1965).

Shkak i këtij aktiviteti u bë botimi i broshurës me titull: "O njerëzit e Zotit..! - thirrja e urtë e Hafiz Sheuqet Boriçit", punuar nga Imam Muhamed B. Sytari.

Në thelb të tij, studimi në fjalë përqendrohet në një hytbe xhumaje, mbajtur nga Hafiz Sheuqet Boriçi në vitin e largët 1940.

Hytbeja në fjalë përmban mesazhe të qytetëruara që lidhen me nxitjen për të punuar, për zhvillimin e ekonomisë, industrisë, bujqësisë, arteve dhe ruajtjes së ekuilibrave në jetë.

"Kush nuk punon, nuk ep dobí dhe nuk është i dobishëm, dhe ai i cili nuk është i dobishëm, është mbi ulët se shtaza e egër!

Në qoftë se ka ndonji popull, të cilin e shtyn dhe e mpron Feja e tij mos me qëndrujë statik në pikëpamje materjale, ai popull do t'ishin muslimanët, të cilët Feja

e tyre i thërret për me i dhanë randësinë e duhur nevojave materjale, dhe i shtyn për me punuë për botën e tyre, me qëllim të plotësisimit t'egzistencës së tyre botnore, tue kërkuë me formuë me 'ta një ideal, një shëmbëll për popujt e tjerë, qi rrojnë mbi faqe të tokës.

Këtë gjë e vërtetojnë edhe disa prej versetevet të naltë kuranor..." - thuhet në një pjesë të saj.

Aktiviteti u hap me fjalën e rastit, mbajtur nga teologu Arben Halluni, që u pasua me një referat mbi jetëshkrimin e Hafizit të nderuar, mbajtur nga teologu Naim Drijaj, imam i xhamisë Parrucë.

Një vështrim mbi botimin e ri dhe simbolikën e mesazheve të Hafiz Sheuqet Boriçi, e mbajti në referatin e tij, shkrimtari Xhahid Bushati.

Mbi vlerën dhe thelbin e kësaj hytbeje dhe botimit të ri, foli autori i tij, Imam Muhamed B. Sytari, Myfti i Zonës Shkodër.

Në fund të këtij aktiviteti, për të pranishmit, u shpërnda edhe botimi i ri kushtuar Hafiz Sheuqet Boriçi.



Nga Enes ibn Maliku (r.a) transmetohet se Pejgamberi (a.s) ka thënë:

*"Dijetarët në tokë janë si shembulli i yjeve, me të cilët orientohesh në tokë dhe në det. Pa qe se yjet shuhen, njerëzit mund ta humbasin drejtimin".*

(Transmetuar nga Imam Ahmedi)

"NË QOFTË SE KA NDONJI  
POPULL, TË CILIN E  
SHTYN DHE E MPRON  
FEJA E TIJ MOS ME  
QËNDRUË STATIK  
NË PIKËPAMJE MATERJALE,  
AI POPULL DO T'ISHIN  
MUSLIMANËT, TË CILËT  
FEJA E TYRE I THËRRET  
PËR ME I DHANË  
RANDËSINË E DUHUR  
NEVOJAVE MATERJALE,  
DHE I SHTYN  
PËR ME PUNUË  
PËR BOTËN E TYRE...!"

HAFIZ SHEUQET BORIÇI  
(1884 - 1956)



Botues:  
**Myftinia Shkodër**  
Drejtues:  
**Imam Muhamed Sytari**

Kryeredaktor:  
**Lavdrim Hamja**

Tel / Fax:  
**+355 (0) 224 2081**  
Nr. llogarie:  
**100054 UBA - Shkodër**

   
**MYFTINIA SHKODER1990**  
**udhaislame@myftinia-shkoder.org**  
**www.myftinia-shkoder.org**